




**QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË KOSOVË
ANALIZË E KORNIZËS LIGJORE DHE
IMPLEMENTIMIT NË PRAKTIKË**





QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË KOSOVË ANALIZË E KORNIZËS LIGJORE DHE IMPLEMENTIMIT NË PRAKTIKË

Përgatitur nga:

Prof. Asst. Dr. Qerkin Berisha

MSc. Gresa Berisha

Mbështetur nga:



SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy.

PËRMBAJTJE

7	1. HYRJE
7	Qasja në Dokumente Publike
8	Mbrojtja e të Dhënave Personale
10	2. QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE
10	2.1 Garancitë Kushtetuese
10	2.2 Korniza Ligjore
12	2.3 Zbatimi i Qasjes në Dokumente Publike në Praktikë
12	2.3.1 Përgjegjësitë ligjore të institucioneve publike
13	2.3.2 Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi
14	2.3.3 Procedurat për kërkesa dhe ankesa për qasje në dokumente publike
16	2.3.4 Sanksionet për mosofrim të qasjes në dokumente publike
17	2.4 Analizë e të Dhënave për Qasjen në Dokumente Publike
18	2.5 Roli i Shoqërisë Civile në Rritjen e Transparencës së Institucioneve Publike
19	2.5 Sfidat në Qasjen e Dokumenteve Publike
20	3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE
20	3.1 Garancitë Kushtetuese
20	3.2 Korniza Ligjore
23	3.3 Zbatimi i Mbrojtjes të të Dhënave Personale në Praktikë
23	3.3.1 Përgjegjësitë ligjore të kontrollorëve dhe përpunuesve të të dhënave
25	3.3.2 Të drejtat e subjekteve të të dhënave
26	3.3.3 Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi
26	3.3.4 Sanksionet për shkelje të të dhënave personale
27	3.4 Analizë e të Dhënave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
29	3.5 Sfidat në Mbrojtjen e të Dhënave Personale
30	4. REZULTATE NGA DISKUTIMET REGJIONALE DHE ANKETIMI
30	4.1 Diskutimet Informuese Regjionale
31	4.2 Anketimi
31	4.2.1 Qasja në Dokumente Publike
33	4.2.2 Mbrojtja e të Dhënave Personale
36	5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME
36	5.1 Qasja në Dokumente Publike në Republikën e Kosovës
37	5.2 Mbrojtja e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës

1. HYRJE

Ky raport zgjerohet në dy fusha, gjegjësisht Qasjen në Dokumente Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të cilat Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) është përcaktuar nga ligjet përkatëse si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të atyre ligjeve dhe trajtimin e ankesave në lidhje me to.

Qasja në Dokumente Publike

Qasja në dokumente publike është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹. Që nga viti 2019, Kosova ka në fuqi Ligjin për Qasje në Dokumente Publike² i cili vlerësohet se ka përmirësuar në përgjithësi rregullativën ligjore dhe ka avancuar qasjen në dokumente publike, krahasuar me legjislacionin paraprak që ka qenë në fuqi gjerë në vitin 2019. Ligji është vlerësuar se është në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e qasjes në dokumente publike. Ligji për Qasje në Dokumente Publike garanton të drejtën e të gjithë personave fizik dhe juridik për të pasur qasje në dokumente të institucioneve publike, ndërsa, Agjencia për Informim dhe Privatësi përcaktohet si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe trajtimin e ankesave. Ligji i vitit 2019 krijoi bazë ligjore më të qartë duke obliguar institucionet që të kenë një qasje me të hapur dhe transparente sa u përket dokumenteve publike, duke përfshirë edhe publikimin dhe ofrimin e qasjes në dokumente publike. Bazuar në këtë ligj, roli i Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) si një institucion i pavarur është i fokusuar në trajtimin e ankesave, dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nga institucionet publike, duke përfshirë edhe ofrimin e ndihmës dhe këshillim të tyre sa i përket procedurave të qasjes në dokumente publike. Ligjet dhe aktet tjera do duhej të jenë në harmoni me kërkesat e ligjit për qasje në dokumente publike, për të rritur më tej transparencën por edhe për të vendosur procedura të qarta në fusha specifike sa i përket qasjes në dokumente publike.

Historiku i rregullimit të qasjes në dokumente publike daton që në vitin 2007, kur Kosova kishte miratuar Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare³, të shfuqizuar më 2010 me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike⁴, i cili ishte në fuqi deri në vitin 2019 derisa u miratua ligji që tashmë është në fuqi. Qasja në dokumente publike ka hasur në sfida të vazhdueshme, ndër të tjera për shkak të hezitimit nga institucionet publike në zbatimin e kërkesave ligjore për ofrim të qasjes në dokumente publike. Rrjedhimisht, në praktikë ekzistojnë shumë raste të mospublikimit të dokumenteve publike, dhe në të njëjtën kohë, edhe raste të refuzimit të qasjes apo ofrimit të qasjes së kufizuar në dokumente publike apo heshtje të institucioneve publike sa u përket kërkesave për qasje në dokumente publike.

AIP ka arritur që viteve të fundit të funksionalizohet⁵, rrjedhimisht është rritur në vazhdimësi edhe numri i ankesave të dorëzuara dhe të trajtuara në këtë institucion. Rritjen e numrit të ankesave duhet parë edhe si një tregues që institucionet publike ende nuk janë plotësisht proaktive në publikimin

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

2 Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>.

3 Ligji Nr. 2003/12 për Qasje në Dokumente Zyrtare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2470>.

4 Ligji Nr. 03/l-215 për Qasje në Dokumente Publike, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>.

5 European Commission, Kosovo 2022 Report, fq. 31-32. I qasshëm në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>.

dhe ofrimin e qasjes në dokumente sipas kërkesave ligjore dhe të palëve të interesuara. Sfidat me të cilat ballafaqohet AIP, në veçanti mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore, do të vazhdojnë të kenë ndikim në arritjen e efekteve të plota të ligjit, duke përfshirë trajtimin e ankesave dhe ofrimin e mbështetjes së duhur për institucionet publike.

Shoqëria civile dhe mediat në Kosovë kanë luajtur një rol pozitiv në përmirësimin e transparencës së institucioneve publike, në veçanti, përmes ushtrimit të kërkesave për qasje në dokumente publike, zbatimit të projekteve të cilat kanë pasur për qëllim rritjen e transparencës së institucioneve publike, avokimit dhe promovimit të të drejtës për qasje në dokumente publike dhe punës së përbashkët me AIP.

Anketat me organizata të shoqërisë civile dhe biznese, si dhe sesionet informuese të bashkëorganizuara gjatë vitit 2023 nga Platforma CIVIKOS dhe AIP në të gjitha regjionet në Kosovë, konfirmojnë nevojën për informim shtesë dhe ngritje të vetëdijes për të drejtën e qasjes në dokumente publike.

Mbrojtja e të Dhënave Personale

Mbrojtja e të dhënave personale në Republikën e Kosovës gëzon mbrojtje kushtetuese dhe ligjore. Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili rregullon të drejtën e privatësisë, garanton të drejta të tilla si respektimi i jetës private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës, konfidencialiteti i korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve, dhe mbrojtja e të dhënave personale. Aty theksohet shprehimisht se *“Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj”*⁶. Përveç kësaj, mbrojtja e privatësisë dhe e të dhënave personale gëzon mbrojtje në nivel kushtetues edhe përmes aplikimit të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës të të drejtave të njeriut të garantuara me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës sipas Nenit 22 të Kushtetutës. Në veçanti duhet përmendur të drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, për të cilat Neni 53 i Kushtetutës i obligon institucionet publike që t’i interpretojnë, në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁷ i vitit 2019 është nxjerrë në harmoni me Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizik sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave (GDPR)⁸. Edhe ky ligj përcakton Agjencinë për Informim dhe Privatësi si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Sa i përket kornizës ligjore që mbulon fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, edhe Raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën thekson se e njëjta është gjerësisht në linjë me Rregulloren e Përgjithshme e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Direktivën për Zbatim të Ligjit⁹. Sidoqoftë, siç u theksua më sipër, Agjencia për Informim dhe Privatësi ballafaqohet me kapacitete të kufizuara njerëzore të cilat krijojnë vështirësi në zbatimin e kësaj kornize ligjore që është tejet e avancuar. Gjatë viteve të fundit, megjithatë, AIP ka ndërmarrë një sërë iniciativash të cilat janë në funksion të avancimit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe ka trajtuar një numër të konsiderueshëm të ankesave, duke shqiptuar edhe gjopa për shkelje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale¹⁰.

Siç analizohet në vijim të këtij raporti, numri i rasteve të shkeljeve të të dhënave personale të trajtuara nga AIP gjatë viteve të fundit, përveç se tregon një funksionalizim të AIP, është tregues edhe i sfidave

6 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 36, Par. 4. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

7 Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>

8 <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2016/679/oj>

9 European Commission, Kosovo 2022 Report, fq. 31-32. I qasshëm në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>

10 Po aty.

me të cilat ballafaqohet Kosova në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale. Duke pas parasysh fushëveprimin e gjerë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, që mbulon edhe sektorin privat, shtimi i kapaciteteve njerëzore të AIP është thelbësor për zbatim të duhur të kërkesave ligjore. Sektori privat dhe ai publik ende nuk kanë arritur të vetëdijesohen në masë të duhur dhe të krijojnë kapacitete sa i përket kërkesave ligjore që ndërlidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Prandaj, roli i AIP në promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale, por edhe në ofrimin e përkrahjes për kontrolluesit dhe përpunuesit për të qenë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbetet esencial.

Anketat me organizata të shoqërisë civile dhe biznese, si dhe sesionet informuese të bashkëorganizuara gjatë vitit 2023 ndërmjet CIVIKOS dhe AIP në të gjitha regjionet në Kosovë konfirmojnë nevojën për informim shtesë dhe ngritje të vetëdijes sa i përket obligimeve ligjore të sektorit privat lidhur me mbrojtjen të dhënave personale. Këshillimi, përgatitja e dokumenteve standarde dhe udhëzuesve sqarues, trajtimi i shpejtë i ankesave të individëve, inspektimi, dhe shqiptimi i gjobave për shkelje të të dhënave personale janë fusha të cilat AIP duhet të fokusohet edhe në të ardhmen.

2. QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

2.1 Garancitë Kushtetuese

E drejta për qasje në dokumente publike është kategori Kushtetuese në Republikën e Kosovës, e rregulluar në kuadër të Kapitullit II [Të drejtat dhe liritë themelore]. Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thekson: “1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike. 2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”¹¹. Prandaj, garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike, përbën një prej themeleve kryesore të institucioneve shtetërore demokratike dhe transparente.

E drejta për qasje në dokumente publike i siguron çdo qytetari të drejtën për t’u informuar mbi veprimtarinë e institucioneve publike dhe lejon qytetarin të marrë informacionin e nevojshëm për të qenë i informuar dhe për të realizuar në mënyrë efikase të drejtat e tij themelore. Kjo e drejtë paraqet një mjet kyç për qytetarët për të monitoruar punën e institucioneve publike në nivelin qendror dhe lokal, ndërsa kontribuon në qeverisjen e mirë të institucioneve, rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies së zyrtarëve publik përmes një niveli më të lartë transparence sa i përket përmbushjes së detyrimeve dhe përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore.

2.2 Korniza Ligjore

Përveç rregullimit kushtetues, e drejta për qasje në dokumente publike është rregulluar në mënyrë të detajuar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe akte nënligjore me të cilat rregullohen procedurat e realizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike. Ligji për Qasje në Dokumente Publike i vitit 2019¹², i garanton çdo qytetari dhe çdo të interesuari, të drejtën që të realizoj të drejtën e tij për qasje në dokumente publike. Me këtë ligj është mundësuar një reformim i kësaj fushe, në kuptimin e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike, përkatësisht zyrtarëve përgjegjës për qasje në dokumente publike në kuadër të këtyre institucioneve, si dhe i jep mandat të qartë ligjor Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) si institucion kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit që të shqyrtoj ankesa të palëve si organ i shkallës së dytë, të cilët për shkak të heshtjes, refuzimit apo ofrimit të qasjes së kufizuar, e kanë pasur të pamundur që të realizojnë të drejtën e tyre ligjore për qasje në dokumente në institucione publike. AIP-së i është dhënë gjithashtu mandat për të nxjerr disa akte nënligjore me qëllim të zbatimit të ligjit dhe zhvillimit të mëtejshëm të procedurave përkatëse të parapara në këtë ligj. Nëse i referohemi dispozitave të Nenit 34, Paragrafi 1 të Ligjit, theksohet: “1. Qeveria me propozim të Agjencisë, miraton akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, më së largu gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.” Ndërsa, në disa dispozita tjera, si Neni 31, Paragrafi 6, thekson: “6. Agjencia nxjerr akt nënligjor për mënyrën e mbajtjes së evidencës dhe raportimit për zbatimin e këtij Ligji.” Prandaj, këto dispozita janë kundërthënëse, dhe krijojnë paqartësi se cilat akte nënligjore i nxjerrë AIP dhe cilat i nxjerrë Qeveria me propozim të AIP-së. Kjo çështje do duhej qartësuar në të ardhmen.

11 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

12 Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Neni 20.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, ka miratuar këto akte nënligjore dhe udhëzues në fushën e qasjes në dokumente publike:

- *Rregullore Nr.02/2022 për Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Ankesave për Qasje në Dokumente Publike*¹³

Rregullorja përcakton rregullat e brendshme të AIP-së për shqyrtimin e ankesave të palëve të cilat i drejtohen AIP-së, si dhe vendimmarrjen lidhur me ankesat në rastet kur institucioni publik dështon të përgjigjet ndaj kërkesës së palës, ia kufizon ose refuzon qasjen në dokumente publike personave fizik apo juridik. Referuar Programit Legjislativ të Akteve Nënligjore¹⁴, AIP ka paraparë ndryshimin e kësaj rregulloreje, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të procedurave dhe proceseve të shqyrtimit të ankesave.

- *Rregullore Nr.01/2023 për Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës dhe Raportimit për Zbatim të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike*¹⁵

Rregullorja përcakton përmbajtjen e evidencës zyrtare lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike nga institucionet publike dhe harmonizon procesin e raportimit të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nga institucionet publike në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

- *Udhëzues Praktik për Lehtësimin e Ushtrimit të Drejtës për Qasje në Dokumente Publike (2021)*¹⁶

Udhëzuesi ka përshkruar në mënyrë të detajuar procesin e zbatimit në praktikë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, duke përfshirë përgatitjen e kërkesës për qasje që u drejtohet institucioneve publike, si dhe çfarë hapa mund të ndërmerren në rastet kur kërkesa për qasje kufizohet apo refuzohet. Udhëzuesi ofron edhe formular standard për tu përdorur në këtë proces.

- *Udhëzuesin për Përmbajtjen e Faqeve të Internetit të Institucioneve Publike (2022)*¹⁷

Përmes udhëzuesit, AIP ka përcaktuar përmbajtjen e uebfaqeve të institucioneve publike dhe dokumentet të cilat institucionet publike obligohen që t'i publikojnë në uebfaqen zyrtare të institucionit përkatës. Sidoqoftë, udhëzuesi ka disa paqartësi në karakterin e tij juridik, prandaj, do të mund të ofronte me shumë sqarime për institucionet publike nga perspektiva e kërkesave të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, pasi vetëm sa i përket këtij aspekti AIP është kompetente.

Në përgjithësi, mund të thuhet se korniza ligjore për qasje në dokumente publike është në linjë me standardet ndërkombëtare të kësaj fushe. Kjo edhe për faktin se shumë nga instrumentet për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në rastin e Kosovës, si pjesë e Kushtetutës. Ndonëse Ligji për Qasje në Dokumente Publike i vitit 2019 nuk përmend harmonizimin me Acquis të BE-së, kërkesat e tij reflektojnë parimet e Rregullores (EC) Nr. 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 30 maj 2001 mbi qasjen publike tek dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike është ligj bazë për këtë fushë, megjithatë, ofrimi i qasjes në dokumente publike, duke përfshirë procedura të transparencës në fushat e ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve publike, publikimi i dokumenteve dhe ofrimi i transparencës duhet të rregullohet në të njëjtën linjë edhe në ligjet tjera specifike, duke mundësuar një harmonizim në mes tyre.

¹³ <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-02-2022-per-proceduren-e-brendshme-te-shqyrtimit-te-ankesave-per-qasje-ne-dokumente-publike/>.

¹⁴ <https://aip.rks-gov.net/download/vendim-02-2023-per-miratimin-e-planit-legjislativ-te-akteve-nenligjore-per-vitin-2023/>.

¹⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=80781>

¹⁶ <https://aip.rks-gov.net/download/udhezues-praktik-per-lehtesimin-e-ushtrimit-te-drejtës-per-qasje-ne-dokumente-publike/>.

¹⁷ <https://aip.rks-gov.net/download/udhezues-per-permbajtjen-e-faqeve-te-internetit-te-institucioneve-publike/>.

2.3 Zbatimi i Qasjes në Dokumente Publike në Praktikë

2.3.1 Përgjegjësitë ligjore të institucioneve publike

Detyrimi për publikim të dokumenteve

Në frymën e zhvillimit të transparencës institucionale dhe llogaridhënies, institucionet publike sipas ligjit janë të obliguara që të zbatojnë të drejtën e qasjes në dokumente publike për të gjithë qytetarët. Në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, çdo institucioni publik ka për detyrë të publikojë dokumentet publike automatikisht pasi ato të jenë përgatitur për publikim. Kjo duhet të ndodhë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas momentit kur dokumentet bëhen të qasshme. Ka raste kur ky rregull nuk aplikohet, në veçanti kur dokumentet publike përmbajnë të dhëna të cilat përbëjnë bazë për refuzim të qasjes në dokumente publike, siç e parasheh Neni 17 i Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike. Mirëpo, në raste të tilla, është obligim i çdo institucioni publik që të bëjë testin e dëmit dhe të interesit publik para se të vendosin që të mos i publikojnë ato dokumente. Institucionet publike i bëjnë publike dokumentet e tyre në njërin nga këto forma:

- Elektronike;
- Të shtypur;
- Përmes transmetimit; apo
- Në çfarëdo forme tjetër e cila mundëson qasjen e numrit sa më të madh të publikut.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike në mënyrë shprehimore përcakton se cilat dokumente duhet të publikohen në mënyrë proaktive nga institucionet publike. Institucionet publike obligohen që publikimin në mënyrë proaktive ta bëjnë në uebfaqen zyrtare të institucioneve përkatëse, dhe atë pavarësisht kërkesës së personit për qasje¹⁸. Disa nga dokumentet publike të cilat institucionet obligohen që në parim t'i publikojnë janë:

- Misionin dhe funksionet e institucionit publik, duke përfshirë edhe ato të njësive në vartësi;
- Zkemën organizative të institucionit publik, duke përfshirë edhe atë të njësive në vartësi;
- Legjislacionin bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e institucionit përkatës;
- Të dhënat e përditshme për veprimtarinë publike të institucionit, aktet ligjore e nënligjore;
- Strategjitë dhe dokumentet e tjera të linjë veprimeve të miratuara, në fushën e veprimit dhe funksionet e institucionit publik;
- Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera ku do të përfshihen edhe:
- Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- Dokumentacioni i nevojshëm dhe kostoja për realizimin e shërbimit;
- Formulari i aplikimit për çdo shërbim dhe udhëzuesi i plotësimit të tij;
- Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar;
- Afati dhe organi ku bëhet ankimi, në rast refuzimi të përgjigjes apo të mos ofrimit të shërbimit në afatin e detyrueshëm ligjor.

Për sa i përket përmbajtjes së uebfaqeve të institucioneve publike, kjo fushë është e rregulluar me Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015¹⁹ për uebfaqet e institucioneve publike. Ky udhëzim administrativ, krahas bazës ligjore të paraparë në Ligjin për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit²⁰, i referohet edhe Nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (i cili është shfuqizuar me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike). Duhet pasur parasysh, që AIP është kompetente vetëm të siguroj së institucionet i publikojnë dokumentet që kërkohen me ligjin për Qasje në Dokumente Publike, por nuk është kompetente të ndërhyj në kompetencat qeveritare për sa i përket menaxhimit të uebfaqeve dhe të diktoj përmbajtjen e tyre. Rrjedhimisht nuk është kompetente as të nxjerrë akte nënligjore të kësaj fushe. Megjithatë, është i domosdoshëm bashkëpunimi me institucionet qeveritare që në proces të nxjerrjes së akteve ligjore dhe nënligjore të jap kontributin e

18 Neni 5, par. 2 i Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

19 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>

20 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8669>

saj në rritjen e transparencës së institucioneve publike, duke reflektuar edhe kërkesat e ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Siç u cek edhe më sipër, AIP, ka nxjerrë Udhëzuesin për përmbajtjen e faqeve të internetit të institucioneve publike, megjithatë, formulimet e përcaktuara në këtë udhëzues, krijojnë disa paqartësi për natyrën e tyre juridike, pasi i njëjti nuk mund të jetë akt nënligjor detyrues. Ky udhëzues mund vetëm të udhëzojë institucionet për sa u përket kërkesave minimale për të publikuar dokumentet e kërkuara me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, por nuk mund të diktoj përmbajtjen e faqeve të institucioneve publike.

Obligimi i çdo institucioni për të pasur një adresë zyrtare të postës elektronike dhe zyrtar për qasje në dokumente publike

Çdo institucioni publik është i obliguar që ta ketë një adresë zyrtare të postës elektronike, me të cilën do të komunikojë me publikun, si dhe të caktojë një person përgjegjës për kontrollimin dhe evidentimin e rregullt të të dhënave të pranuar. Secili institucion publik është i obliguar të ketë të caktuar një zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike.

Obligimi i institucioneve publike për të nxjerrë vendim sipas kërkesës për qasje në dokumente publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike, i obligon institucionet publike që brenda afatit të paraparë ligjor të nxjerrin vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm. Pala e pakënaqur ndaj vendimit apo heshtjes së institucionit publik, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, brenda afatit ligjor dhe sipas procedurës së paraparë për parashtrimin e ankesës.

2.3.2 Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi

AIP është institucion i pavarur, i cili i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. AIP është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. AIP, është institucion kompetent për shqyrtimin e ankesave të pranuar nga palët, të cilat për arsye të ndryshme e kanë pasur të pamundur qasjen në dokumente publike, përkatësisht u është refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesa për qasje në dokumente publike. AIP vendos edhe në rastet kur institucioni publik ka heshtur apo nuk është përgjigjur fare në kërkesën e palës për qasje në dokumente publike. Procedura e shqyrtimit të ankesave dhe vendimmarrjes përcaktohet me ligj dhe me Rregulloren Nr. 02/ 2022 për procedurën e brendshme të shqyrtimit të ankesave për qasje në dokumente publike²¹. Në kuadër të AIP-së, ekziston Departamenti për Qasje në Dokumente Publike, i cili për nga aspekti organizativ është i ndarë në dy divizione:

- *Divizioni për shqyrtim të ankesave*, i cili merret ekskluzivisht me shqyrtimin e ankesave të pranuar nga palët dhe në këtë drejtim mban komunikim të rregullt me institucionet publike dhe me palët ankuuese, organizon dhe mban seanca dëgjimore me palët gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe po ashtu përgatit vendimin përkatës, varësisht nga rasti (vendim pranues, refuzues, përmbyllës e deri në vendimin për shqiptimin e gjobës ndaj institucionit publik).
- *Divizioni për monitorim dhe raportim*, i cili merret kryesisht me monitorimin dhe raportimin në lidhje me përputhshmërinë dhe respektimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nga ana e institucioneve publike, bashkëpunon me institucionet publike dhe koordinon aktivitetet lidhur me trajnimin e zyrtarëve për qasje në dokumente publike dhe mban dhe përditëson një regjistër me të dhënat e zyrtarëve të qasjes në dokumente publike të institucioneve publike.

Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë, në zbatim të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike janë:

²¹ <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-02-2022-per-proceduren-e-brendshme-te-shqyrtimit-te-ankesave-per-qasje-ne-dokumente-publike/>.

- Të monitorojë dhe raportojë në lidhje me përputhshmërinë dhe respektimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nga institucionet publike;
- Të rekomandojë ndryshime dhe reforma të natyrës së përgjithshme, por edhe specifike, të drejtuara një institucioni specifik në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike;
- Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët publikë për qasje në dokumente publike dhe për zbatimin efektiv të ligjit për qasje në dokumente publike;
- Të publikojë detyrimet e institucioneve publike që rrjedhin nga ligji për qasje në dokumente publike, dhe të drejtat e secilit person të parashikuar me këtë ligj;
- *Të ndër marrë dhe shqiptojë ndonjëherë nga masat e parashikuara me ligjin për qasje në dokumentet publike për zbatimin efektiv të ligjit për qasje në dokumente publike.*

AIP ka numër të kufizuar të stafit në departamentin për qasje, e cila ka efekt negativ në përmbushjen e detyrave të saj në mënyrë efikase. Megjithatë, gjatë vitit 2023, është planifikuar të bëhet rekrutimi i një numri shtesë të personelit, që do të ndikonte në rritjen e kapaciteteve të AIP në fushën e qasjes në dokumente publike²². Nga të dhënat e rasteve të pranuar përgjatë viteve të fundit, vërehet një numër i rritur i ankesave parashtruar në AIP, prandaj, në mungesë të burimeve të mjaftueshme njerëzore është i vështirë trajtimi i këtyre ankesave në kohë.

2.3.3 Procedurat për kërkesa dhe ankesa për qasje në dokumente publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike ka vendosur një procedurë të qartë sa i përket parashtrimin të kërkesës për qasje në dokumente publike, dhe mënyrës së përgjigjes nga institucionit publik. Të drejtën për qasje në dokumente publike në Republikën e Kosovës e ka çdo qytetar i cili është në gjendje të bëjë kërkesë për qasje pranë institucionit përkatës publik. Parashtruesi i kërkesës për qasje në dokumente publike, ka të drejtë të kërkojë dokumente dhe informacione nga institucioni publik, përjashtimisht dokumentet apo informacionet të cilat kufizohen për publikun nga ligjet përkatëse në fuqi. Kërkesa për qasje në dokumente pranë institucioneve publike mund të bëhet:

- Në formë të shkruar;
- Në formë elektronike, ose,
- Në mënyrë verbale (në rastet kur kërkesa bëhet në mënyrë verbale, zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike i institucionit publik obligohet që të hartoj kërkesën me shkrim me qëllim të procedimit të mëtejshëm).

Për lehtësimin e procedurës së kërkesës në formë elektronike, Platforma CIVIKOS në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe AIP-në, kanë zhvilluar një platformë – KerkoQasje.com. KerkoQasje ofron informata të thjeshtësuara në lidhje me të drejtat dhe afatet ligjore që dalin nga Ligji për Qasje në Dokumente Publike, liston kontaktet e të gjitha institucioneve publike në nivel lokal, qendror dhe të pavarura, si dhe ofron një shabllon të emaili/kërkesës e cila është shkruar nga zyrtarët ligjor të AIP-së dhe që duhet të plotësohet vetëm me emrin. e dokumentit përkatës që kërkoni qasje.

Procedimi i kërkesës nga zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente i institucionit publik

Me rastin e pranimit të kërkesës për qasje në dokumente publike, institucioni publik, përkatësisht zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike, pas përfundimit të procedurave përkatëse të pranimit, regjistrimit dhe shqyrtimit fillestar, kërkesën për qasje e procedon tek njësia përkatëse brenda institucionit publik që ka në posedim ose kontrollon dokumentin e kërkuar. Secili institucion publik është i obliguar të ketë të caktuar një zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike.

²² AIP, Raporti Vjetor i Punës për vitin 2022, Prishtinë, 2023, fq.17. I qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/raporti-vjetor-i-punes-per-vitin-2021-2/>.

Detyrimi për të vendosur për kërkesën

Për sa i përket vendimmarrjes, zyrtari përgjegjës i institucionit publik (që në kuptim të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është zyrtari më i lartë administrativ i institucionit publik), brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës, me vendim lejon ose refuzon qasjen në dokumentet publike të kërkuara²³. Në rast të refuzimit të plotë ose të pjesshëm, duhet të nxirret vendim i arsyetuar dhe të informohet kërkuuesi për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës, si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë. Dispozitat ligjore lënë hapësirë që institucioni publik vendimin lidhur me ofrimin e qasjes ta vazhdoj edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë, në qoftë se: dokumenti duhet të kërkohet brenda një numri të madh të dokumenteve (siç janë arkivat apo në raste të dosjeve të tenderit apo situata të ngjashme) apo dokumenti i kërkuar nuk është në posedim të institucionit publik që i është kërkuar por në një institucion tjetër publik; ose me një kërkesë kërkohen një numër i madh i dokumenteve publike, nga e njëjta palë. Pavarësisht afateve të përmendura më sipër, në rastet kur dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me mbrojtjen e jetës apo lirisë së një personi, institucioni publik detyrohet të ofroj përgjigje brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve.

Tarifat për qasje në dokumente publike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike përcakton se shikimi i dokumenteve publike në objektet e institucioneve publike është pa pagesë, por duke mos ndaluar caktimin e tarifave për shërbimet e ndërlidhura të ofruara nga bibliotekat, arkivat dhe muzetë. Prandaj, kërkuuesit për kopje të dokumentit publik, mund t'i ngarkohet një tarifë, e cila nuk duhet të tejkalojë shpenzimet e vërteta të riprodhimit dhe furnizimit të dokumentit.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me *Rregulloren Nr. 02/2012/MF*²⁴, ka përcaktuar tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të dokumenteve apo kopjes së dokumenteve. Kjo rregullore është e aplikueshme për të gjitha institucionet publike. Rregullorja parasheh edhe lirimet nga tarifat (Neni 5), në këto raste:

- Shikimi i dokumenteve zyrtare në objektet e institucionit publik (përfshijë arkivat dhe muzetë);
- Skenimi i dokumenteve për t'u dërguar te kërkuuesi me postë elektronike; dhe
- Fotokopja dhe shtypja e dokumenteve deri në 10 faqe.

Detyrimi për ta udhëzuar kërkuuesin

Në rastet kur institucioni publik dokumentin e kërkuar nuk e prodhon, posedon, apo nuk e kontrollon, por që ka njohuri për institucionin publik tjetër që e ka prodhuar, pranuar, disponon apo kontrollon dokumentin publik, menjëherë por jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës, detyrohet që ta informoj dhe ta udhëzoj kërkuuesin për tek institucioni publik përkatës, ndërsa në rastet kur nuk ka informacion për institucionin përkatës, kërkuuesin e udhëzon që t'i drejtohet Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Dorëzimi i ankesave për mosofrim të qasjes Agjencinë për Informim dhe Privatësi

Neni 20 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike parasheh se “ankesa duhet të dorëzohet në afat prej 15 ditësh, pas skadimit të afatit 7 ditor, në rast se institucioni publik ka heshtur, ka aprovuar pjesërisht, ose ka refuzuar kërkesën...”. Prandaj, çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë të parashtroj ankesë në AIP, ndaj çdo veprimi ose mosveprimi, nëse konsideron që institucioni publik ka dështuar të përgjigjet, i ka kufizuar ose refuzuar qasjen në dokumentet publike, siç ka kërkuar subjekti përkatës, sipas Ligjit për Qasjen në Dokumentet Publike. Sipas Neni 10 të Ligjit, ankesa e palës mund të dorëzohet:

²³ Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Neni 12.

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10015>

- Me shkrim;
- Në formë elektronike²⁵; dhe
- Në mënyrë verbale.

Për çdo ankesë të regjistruar, e cila është parashtruar në afat, që i plotëson kriteret e parapara me ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra nga AIP²⁶, ka për detyrë t'ia komunikoj ankesën e pranuar institucionit publik, i cili ka marrë vendim në lidhje me kërkesën për qasje ose që ka dështuar të përgjigjet në kërkesë, duke kërkuar nga institucioni publik që brenda afatit shtatë (7) ditor, të ofroj përgjigje me shkrim ndaj pretendimeve të ngritura nga ankuesi. Në këtë rast, sipas procedurave janë paraparë dy situata:

- Institucioni publik reagon apo kthen përgjigje brenda afatit, dhe Agjencia menjëherë komunikon me palën, duke kërkuar që të deklarohet nëse është e kënaqur apo jo me përgjigjen e pranuar.
- Institucioni publik hesht përkatësisht nuk reagon fare brenda afatit, Agjencia nxjerr Vendim Detyrues, me të cilin e obligon institucion që të ofroj qasje në dokumente publike, sipas kërkesës së palës.

AIP brenda afatit të përcaktuar për ofrimin e qasjes nga ana e institucionit publik, sipas nevojës mund të zhvilloj komunikime tjera me institucionin, apo varësisht nga specifika e rastit, edhe të organizoj takime në formë të konsultimit, në mënyrë që të sigurohet qasja në dokumente publike, përkatësisht pala të gëzoj të drejtën e saj ligjore. Në qoftë se edhe pas afatit dhe komunikimeve të tjera institucioni publik hesht dhe nuk bashkëpunon me AIP, rrjedhimisht nuk ofron qasjen e kërkuar, Ligji i mundëson AIP-së të merr masa, përkatësisht të shqiptoj gjobë ndaj institucionit i cili për arsye të ndryshme ka heshtur, refuzuar apo kufizuar qasjen në dokumente publike.

Në përgjithësi, baza ligjore dhe procedurat e përcaktuara për ofrimin e qasjes në dokumente publike janë të qarta, të thjeshta për t'u kuptuar dhe të mundshme për t'u zbatuar nga çdo institucion publik. Për nga aspekti institucional sfiduese mund të jenë kapacitetet njerëzore në shumë institucione publike, për të ofruar qasjen sipas kërkesave të ligjit për qasje në dokumente publike.

2.3.4 Sanksionet për mosofrim të qasjes në dokumente publike

Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka të parapara dispozita ndëshkuese, respektivisht shqiptimin e gjobave ndaj institucioneve publike, të cilat veprojnë në kundërshtim me kërkesat ligjore. AIP është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, duke përfshirë edhe shqiptimin e gjobave. Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike parashohin dy lloje të gjobave:

- Prej tre mijë (3,000) deri në dhjetë mijë (10,000) € i shqiptohet gjobë institucionit publik i cili në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike e pamundëson, pengon ose kufizon realizimin e të drejtave për qasje në dokumente publike;
- Prej një mijë (1,000) deri në tre mijë (3,000) €, ndëshkohet institucioni publik, i cili nuk përgjigjet fare në kërkesën për qasje në dokumente publike.

AIP para shqiptimit të gjobës, e ka për detyrë të informojë institucionin publik me qëllimin dhe arsyen për shqiptimin e gjobës dhe i ofron një afat kohor, jo më të gjatë se shtatë (7) ditë, për të përmirësuar shkëlqen e evidentuar, në mënyrë që të mos shqiptohet gjoba.

Gjatë vitit 2022 dhe 2023, AIP ka filluar me shqiptimin e gjobave ndaj institucioneve publike, për shkak të moszbatimit të dispozitave të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Shqiptimi i gjobave mendohet se do të arrij efekt pozitiv në rritjen e transparencës së institucioneve publike, dhe ofrimin e qasjes sipas kërkesave ligjore. Në vijim është paraqitur lista e gjobave të shqiptuara.

²⁵ <https://aip.rks-gov.net/ankesat/>.

²⁶ Për sa i përket ankesës, bazuar në rregulloren e nxjerrë nga AIP, e njëjta duhet të përmbajë elementet, si në vijim: a) Përshkrimin e veprimit ose mosveprimit, për të cilin paraqitet ankesa; b) Veprimin konkret që kërkohet nga institucioni publik; c) Shkaqet, arsyet e ankesës, si dhe hollësitë e institucionit publik ndaj të cilit parashtrohet ankesa; d) Emrin e plotë dhe adresën e ankuesit (numrin e telefonit ose adresën elektronike); e) Një kopje të kërkesës për dokumentin/et publik/e, ashtu siç i është dorëzuar institucionit publik; f) Një kopje të përgjigjes së pranuar nga institucioni publik, nëse institucioni publik është përgjigjur.

Nr.	Gjobat e shqiptuara ndaj Institucioneve Publike për vitin 2022	Shuma e gjobës
1	Oda e Avokatëve të Kosovës	€ 3,000.00
2	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	€ 3,000.00
3	Komuna e Kaçanikut	€ 4,000.00
4	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	€ 13,000.00


Tabela 1. Gjobat ndaj Institucioneve Publike (Burimi: AIP, 2022).

Megjithatë, AIP ka filluar të ketë disa vështirësi për sa i përket përmbartimit të gjobave nga ana e disa institucioneve publike. Agjencia ka mundësi ligjore të bëjë ekzekutimin përmes përmbartimit privat, megjithatë, kjo ka një kosto financiare për buxhetin e Agjencisë, të cilin faktikisht nuk e ka të planifikuar deri më tani për këtë qëllim. Ekzekutimi përmes ATK-së, siç ka përcaktuar Nenit 147 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk është praktikuar asnjëherë deri më tani, dhe në vetvete do të ishte problematik për ATK-në, duke pasur parasysh kapacitetet njerëzore. Në të njëjtën kohë, përmbartimi nuk është i mundshëm as përmes Thesarit, duke pasur parasysh kufizimet aktuale ligjore. Prandaj, çështja e përmbartimit të gjobave të shqiptuara për institucionet publike duhet trajtuar në një kontekst më të gjerë ligjor në kuadër të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe jo vetëm për ato të shqiptuara nga AIP.


2.4 Analizë e të Dhënave për Qasjen në Dokumente Publike

Statistikat që ka në dispozicion AIP për kërkesat për qasje në dokumente publike, nuk janë të plota për shkak të mosraportimit të një numri të madh të institucioneve publike. Rrjedhimisht, nuk mund të flasim për statistika të sakta në këtë fushë, duke pasur parasysh që në vitin 2022 nga 171 institucione publike, statistikave të tyre i kanë raportuar vetëm 87 prej tyre, apo rreth gjysma e institucioneve publike, për dallim nga viti 2021 kur kishin statistikave ish-in raportuar nga 103 institucione publike²⁷.

Nëse analizojmë statistikave të vitit 2022 me ato të vitit 2021, shihet se numri i institucioneve që i kanë raportuar statistikave të qasjes në dokumente në AIP ka pësuar rënie, por edhe numri i kërkesave të raportuara si tërësi ka pësuar një rënie të konsiderueshme. Nga analiza e këtyre statistikave shihet se përkundër rënies së numrit të kërkesave të raportuara, është rritur numri i kërkesave të cilave u është kufizuar apo refuzuar qasja. Ndonëse është e vështirë të dihen shkaqet, këto statistika mund të interpretohen si zvogëlim i transparencës dhe tendencë e mbylljes së institucioneve publike për qytetarët.




Grafi 1. Publikimi Proaktiv i Dokumenteve Publike (Burimi: AIP, Raporti Vjetor për Vitin 2022).



Grafi 2. Kërkesat për Qasje në Dokumente Publike (Burimi: AIP, Raporti Vjetor për Vitin 2022).

²⁷ AIP, Raporti Vjetor i Punës për Vitin 2022, Prishtinë, 2023, fq.28. I qasshëm në: <https://aip.rks-gov.net/download/raporti-vjetor-i-punes-per-vitin-2021-2/>.

AIP ka filluar të shqyrtoj ankesat për qasje në dokumente publike që nga pjesa e dytë e vitit 2021, pasi kjo më herët nuk ka qenë kompetencë e AIP-së. Rrjedhimisht, kur bëjmë një krahasim të tillë të numrit të ankesave drejtuar AIP-së në mes të vitit 2021 dhe 2022, duhet të kemi parasysh këtë fakt. Në tabelën në vijim, janë paraqitur ankesat e pranuar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, viti 2022 dhe gjashtëmujori i parë i vitit 2023, për të analizuar trendet e ankesave sa i përket qasjes në dokumente publike.



Grafi 3. Numri i Ankesave (Burimi: AIP).

Nga figura e mësipërme shihet se në vazhdimësi ka pasur një trend rritje të ankesave të dorëzuara në AIP që nga gjashtë mujori i fundit i vitit 2021 deri në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023. Këto statistika mund të interpretohen në dy drejtime. E para, një vetëdijesim i qytetarëve, mediave dhe OJQ-ve për rolin dhe mandatin e AIP si dhe rritje e besimit në AIP. Në anën tjetër, kur analizohen në lidhshmëri me trendet e paraqitura në grafën 2 më sipër, tregojnë për një tendencë të mbylljes së institucioneve publike, duke pasur parasysh rritjen e numrit të kërkesave me qasje të kufizuar dhe të refuzuar. Sipas të dhënave të AIP, nga 421 rastet e ankesave të paraqitura në vitin 2022, qasje e plotë në dokumente publike iu është ofruar kërkuësve vetëm me shkresë njoftuese në njëqind e tetëdhjetë (180) raste/ankesa, ndërsa dyzet e shtatë (47) raste/ankesa janë mbyllur në fazën fillestare të shqyrtimit²⁸. Ndërsa, në 74 raste AIP ka nxjerrë vendime aprovuese, dhe në 4 raste ka shqiptuar gjobë²⁹. Këto statistika tregojnë se shumica e rasteve të kufizimit ose refuzimit të qasjes nga ana e institucioneve publike, kanë qenë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Si faktor të rritjes së numrit të ankesave të dorëzuara në AIP, mund të jenë edhe kampanjat informuese dhe qasja proaktive që ka ndjekur AIP sa i përket informimit të publikut mbi të drejtën për qasje në dokumente publike.

2.5 Roli i Shoqërisë Civile në Rritjen e Transparencës së Institucioneve Publike

Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe mediave në vazhdimësi kanë luajtur rol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në Republikën e Kosovës. OSHC-të kanë monitoruar në vazhdimësi punën e institucioneve publike, dhe në raste të caktuara edhe me kërkesa për qasje në dokumente publike, në lidhje me ato dokumente apo informacione të cilat nuk janë publikuar në mënyrë proaktive nga institucionet publike apo ankesa në rast heshtje apo refuzimi.

Një nga rastet që vlen të përmendet i cili ka pasur impakt të përgjithshëm në rolin e organizatave të shoqërisë civile ndaj institucioneve publike në procesin e llogaridhënies dhe transparencës është rasti i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN)³⁰ ndaj Zyrës së Kryeministrit i vitit 2015, përkatësisht kërkesës për qasje në shpenzimet e Kryeministrit të Kosovës dhe zëvendësve të tij, në vizitat jashtë

28 AIP, Raporti Vjetor i Punës për 2022, f. 27.

29 Po aty.

30 <https://kallxo.com/shkurt/permbledhje-lajmeve/birn-fiton-rastin-gjyqesor-ndaj-zyres-se-kryeministrit/>

vendit. Në këtë rast, Gjykata në Aktgjykimin e plotfuqishëm ka vendosur në favor të BIRN ndaj Zyrës së Kryeministrit, duke obliguar këtë të fundit që të ofroj qasjen në informacionin e kërkuar. Ky rast, por edhe shumë raste të tjera të iniciuara nga ana e OJQ-ve, ka ndikuar që institucionet publike të rrisin transparencën dhe të ofrojnë qasje në informata dhe dokumente të natyrës së ngjashme.

AIP është duke bashkëpunuar ngushtë me organizatat e shoqërisë civile për të implementuar projekte të cilat kanë për qëllim rritjen e transparencës së institucioneve publike në përgjithësi.

2.6 Sfidat në Qasjen e Dokumenteve Publike

Disa nga sfidat kryesore në lidhje me me qasje në dokumente publike janë:

- Heshtja e institucioneve në kërkesat për qasje në dokumente publike;
- Ofrimi i qasjes së kufizuar në dokumente publike;
- Refuzimi i qasjes në dokumente publike dhe mospublikimi në mënyrë proaktive i dokumenteve publike nga ana e institucioneve publike;
- Tendenca e mosbashkëpunimit të disa institucioneve publike me AIP-në, duke përfshirë edhe moszbatimin e vendimeve dhe mos pagesën e gjobave të shqiptuara.
- Mungesa e kapaciteteve financiare të AIP për të përmbuar gjobat e tilla, dhe pamundësia ligjore që kjo të bëhet përmes Thesarit;
- Mungesa e kapaciteteve njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, e përcjellë me mungesa në pozita të rëndësishme brenda institucionit.

Ky fakt është evidentuar në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2022 por edhe në Raportin Vjetor të Punës të AIP për vitin 2022, si edhe Planin e performancës për vitin 2023³¹. Këto sfida institucionale janë reflektim edhe i kapaciteteve të limituara buxhetore për të rekrutuar personel, për të trajnuar atë në linjë me zhvillimet në vendet e BE-së, edhe sa i përket qasjes po edhe mbrojtjes të të dhënave personale. Një numër i konsiderueshëm i pozitave profesionale të AIP-së të aprovuara me buxhet dhe sipas organogramit, mbeten të paplotësuara, gjë që sjellë pasoja në kualitetin dhe efikasitetin e AIP;

- Mungesa e kapaciteteve adekuate të institucioneve publike dhe mungesa e vetëdijes për të respektuar kërkesat e ligjit për qasje në dokumente publike.

Kjo përfshinë edhe mosçaktivimin e zyrtarëve për qasje në dokumente publike dhe mungesën e përgatitjes adekuate të tyre për të ofruar qasje në dokumente publike. Roli informues, trajnues dhe vetëdijësues i AIP është i nevojshëm në këtë aspekt;

- Nevoja për të harmonizuar kornizën tjetër ligjore me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Çdo institucion publik është i obliguar që në kuptim të zhvillimit të transparencës dhe llogaridhënies, me rastin e nxjerrjes së akteve të tyre të brendshme, të njëjtat t'i harmonizojnë me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

31 <https://aip.rks-gov.net/download/plani-i-performances-per-vitin-2023/?epdmdl=2686&refresh=64c9fb-63976ca1690958691>.

3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

3.1 Garancitë Kushtetuese

Mbrojtja e të dhënave personale në Republikën e Kosovës është kategori kushtetuese. Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili rregullon të drejtën e privatësisë, garanton të drejta të tilla si respektimi i jetës private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës, konfidencialiteti i korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve, dhe mbrojtja e të dhënave personale. Këto dispozita përcaktojnë shprehimisht se *“secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj”*³². Përveç kësaj, mbrojtja e privatësisë dhe e të dhënave personale gëzon mbrojtje në nivel kushtetues edhe përmes aplikimit të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës të të drejtave të njeriut të garantuara me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovës sipas Nenit 22 të Kushtetutës. Në veçanti duhet përmendur të drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, për të cilat Neni 53 i Kushtetutës i obligon institucionet publike që ti interpretojnë, në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, pjesa e privatësisë në përgjithësi, ajo e mbrojtjes së të dhënave personale në veçanti, është e rregulluar mjaft mirë si pjesë e Kushtetutës dhe instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë.

3.2 Korniza Ligjore

Përveç rregullimit bazë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe si pjesë e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të përfshira në Nenin 32 të Kushtetutës, mbrojtja e të dhënave personale është rregulluar në mënyrë të detajuar me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP)³³ dhe një numër të konsiderueshëm të akteve nënligjore që kanë për qëllim operacionalizimin e zbatimit praktik të dispozitave të këtij ligji. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i vitit 2019 është harmonizuar me Acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, dhe në masë të madhe me kërkesat e Rregullores (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 mbi mbrojtjen e personave fizik në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e direktivës 95/46/EC (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave), e cila njihet edhe si Rregullorja e GDPR.³⁴ Një fakt i tillë përmendet edhe në Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, në të cilin theksohet se sa i përket kornizës ligjore që mbulon fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, e njëjta është gjerësisht në linjë Rregulloren e Përgjithshme e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Direktivën për Zbatim të Ligjit. Megjithatë, kur përmendet harmonizimi me legjislacionin e BE-së, nuk mjafton që thjeshtë korniza ligjore të jetë e harmonizuar, por edhe mekanizmat zbatuese dhe zbatimi në praktikë të jenë në linjë me kërkesat e Acquis të BE-së. Prandaj, nëse analizohet në tërësi sistemi i mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë, i njëjti ballafaqohet me sfida të konsiderueshme në zbatim të drejtë të kësaj baze ligjore në praktikë.

32 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 36, Par. 4. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

33 Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>.

34 GRPR, <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2016/679/oj>.

Harmonizimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Rregulloren e GDPR, ka ndikim pozitiv tek kontrolluesit e të dhënave personale në Republikën e Kosovës, pasi që të njëjtit krahas zbatimit të ligjit në fjalë, kanë mundësinë të harmonizojnë edhe aktet e tyre të brendshme dhe proceset lidhur me përpunimin e të dhënave personale, në mënyrë të njëjtë siç i zbatojnë edhe kontrolluesit jashtë Republikës së Kosovës, me të cilët këta kontrollues kanë bashkëpunim biznesi të përditshëm apo praktikisht edhe janë degë e tyre në Republikën e Kosovës.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i vitit 2019, është pothuajse në tërësi i harmonizuar me GDPR të BE-së, dhe ndër të tjera rregullon këto çështje që janë kyçe edhe nga perspektiva e GDPR:

- AIP themelohet me këtë ligj si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Dispozitat e ligjit zbatohen për subjektet publike dhe private (kontrolluesit) që përpunojnë të dhënat personale të individëve brenda Republikës së Kosovës, dhe zbatohet edhe në përfaqësitë diplomatike të Kosovës jashtë vendit.
- Subjektet kontrolluese duhet të kenë një bazë ligjore të vlefshme për përpunimin e të dhënave personale. Këto baza ligjore përfshijnë pëlqimin, përmbushjen e kontratës, detyrimin ligjor, mbrojtjen e interesave jetike, detyrën publike dhe interesat legjitime.
- Nëse një subjekt kontrollues mbështetet në pëlqimin e subjektit të të dhënave si bazë ligjore për përpunimin e të dhënave personale, ai pëlqim duhet të jepet lirisht, të jetë specifik, i informuar dhe i dhënë në mënyrë të qartë. Individët si subjekte të të dhënave kanë të drejtë të tërheqin pëlqimin e dhënë në çdo kohë.
- Ligji u jep individëve të drejta të ndryshme, duke përfshirë të drejtën për t'iu qasur të dhënave të tyre personale, për të korigjuar të dhënat e pasakta, për të fshirë të dhënat ("e drejta për t'u harruar"), për të kufizuar përpunimin dhe bartjen e të dhënave dhe për të kundërshtuar përpunimin.
- Bazuar në Nenet 37-39 të ligjit, disa organizatave si subjekte kontrolluese u kërkohet të caktojnë një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e aktiviteteve të mbrojtjes së të dhënave brenda organizatës.
- Sipas Nenet 33, kontrolluesit duhet të raportojnë shkeljet e të dhënave tek AIP brenda 72 orëve nga dijenia për shkeljen, përveç rasteve kur shkelja nuk ka gjasa të rezultojë në rrezik për të drejtat dhe liritë e individëve.
- Nenet 44-51 vendosin rregulla për transferimin e të dhënave personale jashtë Kosovës dhe në linjë me vendimet e BE-së. Transferimet drejt vendeve që nuk ofrojnë një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave mund të kërkojnë masa mbrojtëse shtesë.
- Kontrolluesit duhet të demonstrojnë pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative. Ata duhet të mbajnë shënime për aktivitetet e tyre të përpunimit të të dhënave.
- Ligji kërkon që kontrolluesit të përfshijnë parimet e mbrojtjes së të dhënave në hartimin e sistemeve dhe proceseve të tyre që në fillim (privatësia sipas dizajnit) dhe të sigurojnë që, si parazgjedhje, të përpunohen vetëm të dhënat personale të nevojshme.
- Sipas Neneve 35-36 të Ligjit, kontrolluesit duhet të kryejnë vlerësim të ndikimit për përpunim që ka të ngjarë të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e individëve. Vlerësimi ka për qëllim të ndihmojë në vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve që lidhen me përpunimin e të dhënave.
- AIP ka fuqinë të vendos gjoba të konsiderueshme për shkeljet të të ligjit, të cilat mund të jenë deri 4% të qarkullimit të përgjithshëm vjetor të vitit financiar paraprak të subjektit. Në të njëjtën kohë mund të vendosen gjoba edhe ndaj personave përgjegjës.

Në kuadër të dispozitave ligjore, të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është paraparë nxjerrja e një sërë aktesh nënligjore për rregullimin në mënyrë të detajuar të shumë proceseve, të parapara me ligj. Aktet nënligjore në fjalë në bazë të ligjit janë të parapara të nxirren nga AIP, me përjashtim të një akti nënligjor i cili parashihet të nxjerrët nga Qeveria. AIP ka nxjerrë këto akte nënligjore:

- *Rregullore Nr.01/2022 (AIP) për Mënyrën e Ruajtjes dhe Shfrytëzimit të Materialit Arkivor dhe Protokollit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi*³⁵;
- *Rregullore Nr.02/ 2022 për Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Ankesave për Qasje në Dokumente Publike*³⁶;
- *Rregullore Nr.03/2022 për Mënyrën e Kryerjes së Inspektimit dhe Kontrollit*³⁷;
- *Rregullore Nr. 04-2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*³⁸;
- *Rregullore Nr. 05/2022 mbi Masat e Sigurisë Gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale*³⁹;
- *Rregullore Nr. 06/2022 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Autorizimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale*⁴⁰.

Shihet se aktet nënligjore të nxjerra nga AIP nuk janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Duke pas parasysh që AIP e ka kompetencë ligjore nxjerrjen e këtyre akteve dhe që ato janë të ndërlidhura me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do duhej të publikoheshin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Përveç aspektit formal juridik, publikimi në Gazetën Zyrtare do të kishte efekte më të mira edhe të informimit për kornizën ligjore në fuqi.

Krahas akteve nënligjore të përmendura më sipër, AIP ende nuk ka kompletuar të gjithë kornizën e legjislacionit sekondar të paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndonëse në Planin Legjislativ të Akteve Nënligjore për vitin 2023⁴¹ është paraparë hartimi i këtyre akteve që mungojnë. Disa nga fushat që pritet të mbulohen me aktet nënligjore që nuk janë nxjerrë ende, janë komplekse dhe ende nuk janë rregulluar në mënyrë të detajuar as në vendet e rajonit, rrjedhimisht, janë fusha komplekse dhe kërkojnë ekspertizë specifike. Rregulloret në vijim janë paraparë në kuadër të planit legjislativ të AIP për 2023:

- *Rregullore për Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurave për Lëshimin e Certifikatës për Përpunimin e të Dhënave Personale;*
- *Rregullore për Përcaktimin e Tarifave për Njoftimet dhe Autorizimet;*
- *Rregullore për Mënyrën e Përpunimit të të Dhënave, të cilat Merren nga Përdorimi i Dronëve.*

AIP ka nxjerrë edhe udhëzues për të ofruar lehtësi në procesin e zbatimit të legjislacioni primar dhe dytësor, si në vijim:

- *Udhëzues për Parti Politike gjatë Zhvillimit të Fushatës Zgjedhore*⁴²;
- *Udhëzues për Përdorimin e Sistemit të Vëzhgimit me Kamerë për Kontrolluesit e të Dhënave*⁴³;
- *Udhëzues për Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllim të Marketingut të Drejtpërdrejtë*⁴⁴.

AIP ka hapësirë të mjaftueshme ligjore për të nxjerrë udhëzues që kanë të bëjnë me zbatimin e detajuar të dispozitave ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Prandaj, duke pasur parasysh fushëveprimin e gjerë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AIP ka hapësirë ligjore të nxjerrë

35 <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-01-2022-aip-per-menyren-e-ruajtjes-dhe-shfrytezimit-te-materialit-arkivor-dhe-protokollit-se-agjencise-per-informim-dhe-privatesi/>

36 <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-02-2022-per-proceduren-e-brendshme-te-shqyrtimit-te-ankesave-per-qasje-ne-dokumente-publike/>

37 <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-03-2022-per-menyren-e-kryerjes-se-inspektimit-dhe-kontrollit/>

38 <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-04-2022-per-proceduren-e-brendshme-per-shqyrtimin-e-ankesave-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale/>

39 <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-05-2022-mbi-masat-e-sigurise-gjate-perpunimit-te-te-dhenave-personale/>

40 <https://aip.rks-gov.net/download/rregullore-nr-06-2022-mbi-proceduren-e-brendshme-te-shqyrtimit-te-kerkesave-per-autorizimin-e-transferimit-nderkombetar-te-te-dhenave-personale/>

41 <https://aip.rks-gov.net/download/vendim-02-2023-per-miratimin-e-planit-legjislativ-te-akteve-nenligjore-per-vitin-2023/>

42 <https://aip.rks-gov.net/download/udhezues-per-parti-politike-gjate-zhvillimit-te-fushates-zgjedhore/>

43 <https://aip.rks-gov.net/download/udhezues-per-perdorimin-e-sistemit-te-vezhgimit-me-kamere-per-kontrolluesit-e-te-dhenave/>

44 <https://aip.rks-gov.net/download/udhezues-per-perpunimin-e-te-dhenave-personale-per-qellim-te-marketingut-te-drejtperdrejte-2/>

udhëzues në pothuajse çdo fushë që mbulon ligji, të cilat do të fokusoheshin në këto çështje:

- Ofrimi i informacionit të saktë për qytetarët dhe bizneset në lidhje me mbrojtjen e të dhënave duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me përpunimin e të dhënave do të ndihmonte në përmirësimin e përgjegjshmërisë së sektorit privat si përpunues dhe kontrollues të të dhënave.
- Sigurimi i udhëzimeve të duhura në lidhje me përpunimin e të dhënave për sektorin privat, duke përfshirë udhëzimet për përgatitjen e politikave të brendshme të mbrojtjes së të dhënave nga sektori privat, do të ndihmonte në zbatim të duhur të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Sigurimi i modeleve të marrëveshjeve për përpunimin e të dhënave dhe dokumenteve të ngjashme model që do të përmirësojnë zbatimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave nga sektori privat. Kjo do të përmirësojë kapacitetin e sektorit privat për të zbatuar siç duhet kërkesat e mbrojtjes së të dhënave;

Megjithatë, ofrimi i manualëve shtesë dhe këshillave për sektorin privat, me numrin e kufizuar të kapaciteteve njerëzore që aktualisht ka në dispozicion AIP është shumë i kufizuar. Prandaj, përmirësimi të kapaciteteve institucionale të Agjencisë së Informacionit dhe Privatësisë në dhënien e këshillave për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për sektorin privat, duhet të jetë ndër prioritetet kryesore të AIP-së.

3.3 Zbatimi i Mbrojtjes të të Dhënave Personale në Praktikë

3.3.1 Përgjegjësitë ligjore të kontrollorëve dhe përpunuesve të të dhënave

Një nga hapat e parë që duhet të marrin institucionet publike dhe private (kontrolluesit) në procesin e implementimit të procedurave përkatëse për mbrojtjen e të dhënave personale është caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale. Ligji përcakton se zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale caktohet duke u bazuar në aftësitë profesionale, e në veçanti në bazë të ekspertizës në mbrojtjen e të dhënave personale. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale mund të caktohet nga radhët e personelit të kontrolluesit apo përpunuesit. Kjo përfshinë edhe kontraktimin me kontratë shërbimi. Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale është edhe pikë kontakti me AIP, dhe ka për obligim të këshillojë kontrolluesit ose përpunuesit dhe të punësuarit e tyre lidhur me detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre në implementimin e kërkesave që dalin sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Subjektet që kontrollojnë dhe përpunojnë të dhëna personale duhet të⁴⁵:

- Marrin parasysh qëllimin, objektin, natyrën, kontekstin e çdo aktiviteti të përpunimit të të dhënave;
- Marrin parasysh mundësinë e ndonjë rreziku të rëndë për liritë dhe të drejtat e çdo personi fizik;
- *Të zbatojnë masat e duhura organizative dhe teknike dhe masat e sigurisë që tregojnë se aktivitetet e përpunimit të të dhënave janë kryer në përputhje me LMDHP-në;*
- Rishikojnë dhe përditësojnë këto masa sipas nevojës.

Përveç kontrolluesve, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parasheh edhe përpunuesit e të dhënave personale. Bazuar në Nenin 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përpunuesi përpunon të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit, përveç kur me ndonjë ligj të veçantë i kërkohet ta bëjë këtë. Detyrat e përpunuesit ndaj kontrolluesit duhet të përcaktohen nëpërmjet kontratës për përpunimin e të dhënave personale të lidhur ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit. Prandaj, edhe pse nuk kanë të njëjtat detyrime si kontrolluesit, përpunuesit e të dhënave, kanë disa detyrime të drejtpërdrejta të parapara në ligj. Në rast të shkeljeve të të dhënave personale të tyre, subjektet e të dhënave mund të parashtrajnë në gjykatë pretendime për kompensim si ndaj kontrolluesve të të dhënave ashtu edhe ndaj përpunuesve të të dhënave.

⁴⁵ Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Neni 23.

Kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parasheh që në çdo rast të përpunimit të të dhënave personale nga ana e kontrolluesve, të zbatohet baza ligjore e përpunimit e paraparë në Nenin 5 të Ligjit. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave është e detyrueshme për të siguruar legjitimitetin e përpunimit të të dhënave e paraparë me ligj.

Prandaj, sipas Nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁴⁶, çdo kontrollues i cili dëshiron të mbledhë, ruajë, publikojë, shpërndajë, fshijë ose asgjësojë të dhënat personale, duhet të ketë bazë ligjore për përpunimin e tillë. Në vijim janë përfshirë bazat ligjore mbi të cilat mund të ndodh përpunimi:

- ***Pëlqimit*** - që nënkupton se subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë që kontrolluesi të përpunojë të dhënat e tij personale për një qëllim të caktuar;
- ***Kontratës*** - përpunimi është i nevojshëm për një kontratë që kontrolluesi ka me subjektin e të dhënave, ose sepse subjektet kanë kërkuar të ndërmerren hapa të veçantë nga kontrolluesi përpara se të lidhin një kontratë;
- ***Detyrimet ligjor*** - përpunimi është i nevojshëm që kontrolluesit të jenë në përputhje me ligjin (duke mos përfshirë detyrimet kontraktuale);
- ***Interesit vital*** - përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur jetën e dikujt;
- ***Interesi publik*** - përpunimi është i nevojshëm që kontrolluesi të kryen një detyrë në interes publik ose për funksionet tija zyrtare, dhe detyra ose funksioni është i përcaktuar qartë në ligj;
- ***Interesi Legjitim*** - përpunimi është i nevojshëm për interesat legjitime të kontrolluesit ose interesat legjitime të një palë të tretë, përveç rastit kur ka një arsye të mirë për të mbrojtur të dhënat personale të individit që i tejkalon ato interesa legjitime.

Nëse analizojmë këto baza ligjore të përpunimit shohim se kërkesat ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë në linjë me kërkesat e GDPR të BE-së.

Masat teknike dhe organizative për mbrojtjes së të dhënave personale

Kontrolluesi ka për obligim që me rastin e përpunimit të të dhënave personale të subjekteve, të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për sigurinë e të dhënave personale, përkatesisht të ndërmarrë veprime dhe masa të nevojshme për mbrojtjen e këtyre të dhënave. Të gjitha masat që janë të obliguar të ndërmarrin kontrolluesit, duhet të merren me qëllim që të parandalohet rreziku nga përpunimi i të dhënave nga të cilat mund të shkaktohen dëme fizike, materiale dhe jomateriale, si: diskriminimin, vjedhje të identitetit ose mashtrim, humbje financiare, dëmtim të reputacionit, si dhe humbje të konfidencialitetit të të dhënave personale të mbrojtura nga sekreti profesional etj.

Prandaj, për të evituar shkeljet, kontrolluesi duhet të sigurohet që me rastin e përpunimit, të zbatoj masa të duhura teknike dhe organizative, për të siguruar nivel sigurie të duhur dhe të përshtatshëm të përpunimit të të dhënave. Sipas ligjit, *shkelje të të dhënave* nënkuptohet **çdo veprim që qon në shkatërrim, humbje, ndryshim aksidental ose të paligjshëm, zbulim të paautorizuar ose qasje në të dhëna që janë transferuar ose përpunuar në mënyrë tjetër**. Kontrolluesi është i detyruar të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm në përpjesëtim me rrezikun e përpunimit të të dhënave personale, me qëllim të parandalimit të një shkeljeje të mundshme të të dhënave personale. Kontrolluesi duhet të miratojë aktet e brendshme për të udhëzuar zbatimin e masave të duhura dhe për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore. Sa u përket masave teknike të sigurisë, ato kanë të bëjë me masat mbrojtëse që vendosen në vendndodhje fizike, sisteme/pajisje të teknologjisë informative që përdoren brenda kontrolluesit ose si pjesë e produkteve përfundimtare që përdoren dhe që lidhen me përpunimin e të dhënave personale. Kjo përfshinë edhe rregullimin kontraktual të masave teknike që kontrolluesi rregullon me palët e treta që kanë qasje në të dhënat personale ose me të cilët ajo merr pjesë në përpunimin e të dhënave. Disa nga masat teknike që kontrolluesit duhet të zbatojnë janë paraparë me Nenin 31 të Ligjit për Mbrojtjen

⁴⁶ Neni 5 i Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

e të Dhënave Personale si në vijim:

- Pseudonimizimi dhe enkriptimi i të dhënave personale;
- Aftësia për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në vazhdim të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;
- Përdorimi i fjalëkalimeve të forta në kompjuterë, krijimi i kopjeve rezervë të të dhënave;
- Aftësia për të rivendosur disponueshmërinë dhe qasjen në të dhënat personale në kohën e duhur, në rastin e një incidenti fizik ose teknik;
- Procesi i testimit, vlerësimit të rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit;
- Përdorimi i programeve antivirus, etj.

3.3.2 Të drejtat e subjekteve të të dhënave

Në procesin e përpunimit të të dhënave personale nga ana e kontrolluesve, personi fizik është pala kryesore dhe qendrore e këtij procesi, të cilin Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e konsideron si “Subjekt i të Dhënave”. Prandaj, subjekti i të dhënave sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale gëzon të drejta si subjekti i të dhënave, të cilat janë në përgjegjësinë e kontrolluesit që t’i zbatoj këto të drejta. Në linjë me këtë, çdo kontrollues, që përpunon të dhëna personale, është i obliguar që të ofrojë informacion të nevojshëm për subjektin e të dhënave, lidhur me të dhënat e tij që do të përpunohen. Nenin 12 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka listuar informacionet e detajuara që duhet t’i ofrohen subjektit të të dhënave. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë nga kontrolluesi korrigjimin e të dhënave të pasakta në lidhje me të, duke plotësuar të dhënat personale të paplota⁴⁷.

Një e drejtë shumë e rëndësishme që i takon subjektit të të dhënave është e drejta e fshirjes apo “E drejta për t’u harruar”⁴⁸. E drejta për t’u harruar, zakonisht zbatohet në rastet kur ekzistojnë një nga shkaqet e mëposhtme:

- Të dhënat personale nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimet, për të cilat ato janë mbledhur ose përpunuar;
- Subjekti i të dhënave e tërheq pëlqimin mbi të cilin bazohet përpunimi sipas Nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. ose Nenit 8 paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të ligjit dhe nëse nuk ka shkak tjetër ligjor për përpunimin;
- Subjekti i të dhënave e kundërshton përpunimin në pajtim me Nenin 20 paragrafi 1. të ligjit dhe nuk ka shkaqe legjitime mbizotëruese për përpunimin, ose subjekti i të dhënave e kundërshton përpunimin në pajtim me Nenin 20 paragrafi 2 të ligjit;
- Të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme;
- të dhënat personale duhet të fshihen për të përmbushur një detyrim ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;
- Të dhënat personale janë mbledhur në lidhje me ofertën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit të referuara në Nenin 7 paragrafi 1 të ligjit.

Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përfitoj nga kontrolluesi kufizimin e përpunimit, nëse zbatohet një nga kriteret e mëposhtme:

- Saktësia e të dhënave personale kundërshtohet nga subjekti i të dhënave për një afat që i mundëson kontrolluesit të verifikojë saktësinë e të dhënave personale;
- Përpunimi është i paligjshëm dhe subjekti i të dhënave e kundërshton fshirjen e të dhënave personale dhe në vend të saj kërkon kufizimin e përdorimit të tyre;
- Kontrolluesit nuk vazhdojnë t’i duhen të dhënat personale për qëllimet e përpunimit, por ato kërkohen nga subjekti i të dhënave për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore;
- Subjekti i të dhënave e ka kundërshtuar përpunimin në pajtim me Nenin 20 paragrafi 1 të ligjit në pritje të verifikimit nëse shkaqet legjitime të kontrolluesit mbizotërojnë ndaj atyre të subjektit të të dhënave.

⁴⁷ Po aty, Neni 15.

⁴⁸ Po aty, Neni 16.

Sipas Nenit 20 të Ligjit, subjekti i të dhënave ka të drejtë të njoftohet në rastet kur transferohen të dhënat e tij personale nga një kontrollues tek një kontrollues tjetër, si dhe të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave të tij personale.

Subjekti i të dhënave në procesin e përpunimit të të dhënave personale është në pikën qendrore, dhe të drejtat e tij të garantuara me ligj janë të drejta ekskluzive të parapara, me qëllim që të sigurohet përpunimi i të dhënave personale në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në çdo rast të garantohet siguria juridike e subjektit të të dhënave personale.

3.3.3 Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i vitit 2019 është nxjerrë në harmoni me Rregulloren për GDPR të BE-së, prandaj edhe roli i AIP-së, i rregulluar me këtë ligj është në linjë me kërkesat e BE-së për një autoritet të pavarur dhe me kompetenca të plota në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale. Prandaj, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AIP është përgjegjëse dhe ka kompetenca të plota për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit si në vijim:

- Pranimin dhe shqyrtimin e ankesave për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Zhvillimin, planifikimin dhe ndërmarrjen e veprimeve inspektuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Mbikëqyrjen e përshtatshmërisë së procedurave dhe masave të marra për sigurinë e të dhënave personale në pajtim me ligjin;
- Përgatitjen dhe zhvillimin e fushatave vetëdijësuese, informuese për qytetarët lidhur me të drejtat e tyre si subjekte të të dhënave personale dhe zhvillon fushata informuese për kontrolluesit publik dhe privat mbi detyrimet ligjore lidhur me përpunimin e të dhënave personale;
- Hulumtimin dhe analizimin e trendeve të zhvillimit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale duke përfshirë ofrimin e rekomandime përkatëse;
- Ofrimin e këshillave për Kuvendin, Qeverinë, institucionet dhe organet e tjera mbi masat legjislative dhe administrative në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizik për sa i takon përpunimit të të dhënave personale.

Megjithatë, Agjencia për Privatësi ballafaqohet me kapacitete të kufizuara njerëzore të cilat krijojnë vështirësi në zbatimin e kësaj kornize ligjore që është tejet e avancuar. Kjo konfirmohet edhe në Raportin e fundit të Komisionit Evropian për Kosovën⁴⁹. Gjatë viteve të fundit, megjithatë, AIP ka ndërmarrë një serë iniciativash të cilat janë në funksion të avancimit të mbrojtjes të të dhënave personale dhe ka trajtuar një numër të konsiderueshëm të ankesave, duke shqiptuar edhe gjopa për shkelje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale⁵⁰.

3.3.4 Sanksionet për shkelje të të dhënave personale

Në Nenin 92 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë paraparë edhe sanksionet për secilën situatë të shkeljes së të dhënave personale. AIP-së i është dhënë kompetencë e plotë për shqiptimi i gjobave ndaj kontrolluesve të të dhënave të cilët veprojnë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Siç u përmend më sipër, dispozitat ligjore kanë definuar se çka është shkelja e të dhënave personale, dhe shqiptimi i gjobave financiare nga ana e AIP ndryshon nga shkeljet e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përfshirë gjobat për shkeljet ndaj dispozitave të përgjithshme të ligjit, e deri tek përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale, marketingu i drejtpërdrejtë, vëzhgimi me kamerë, karakteristikat biometrike etj. Ndaj personave fizik mund të shqiptohen gjopa nga dyqind euro (200 €) deri në dy mijë euro (2000 €), ndërsa ato ndaj personave juridik nga katër mijë euro (4.000 €) deri në katër dhjetë mijë euro (40.000 €).

49 European Commission, Kosovo 2022 Report, fq. 31-32. I qasshëm në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>.


50 Po aty.

3.4 Analizë e të Dhënave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nga të dhënat e prezantuara në grafet në vijim, vërehet një rritje e ndjeshme e numrit të rasteve të cilat janë pranuar në formë ankesë në AIP. Nga këto statistika shihet se kemi një rritje të numrit të ankesave në veçanti sa i përket keqpërdorimit të të dhënave personale, marketingut të drejtpërdrejtë dhe vëzhgimit me kamerë. Edhe numri i vendimeve të nxjerra nga AIP gjatë vitit 2022 është rritur. Nga të dhënat e raportuara nga AIP për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, vërehet një trend i përafërt i ankesave krahasuar me vitin 2022. Rritja e numrit të ankesave mund të arsyetohet me funksionalizimin e AIP dhe fushatave vetëdijesuese nga AIP. Të dhënat statistikore të ankesave të paraqitura, por edhe të gjobave të shqiptuara gjatë kësaj periudhe, janë tregues i sfidave me të cilat ballafaqohet Kosova në fushën e pajtueshmërisë me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



Grafi 4. Ankesat e Pranuar nga AIP



Grafi 5. Vendimet e Nxjerra nga AIP

Agjencia për Informim dhe Privatësi, ka ndërmarrë veprime me qëllim të inspektimit dhe kontrollit tek kontrolluesit e të dhënave personale. Rrjedhimisht, AIP ka rritur në masë të madhe numrin e inspektimeve sipas detyrës zyrtare dhe sipas kërkesës gjatë vitit 2022. Mbetet shqetësues numri i madh i rasteve ku institucionet publike kanë vendosur kamera vëzhguese në kundërshtim me kërkesat ligjore. Gjatë vitit 2022, nga inspektimet e AIP-së në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, është konstatuar që në disa nga komunat është evidentuar sistemi i vëzhgimit me kamerë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku janë ndërmarrë veprime konkrete, në bashkëpunim me institucionet kompetente për siguri, që ato kamera të sekuestrohen, përkatësisht të hiqen nga përdorimi.⁵¹ Në disa nga rastet janë konfiskuar kamerat e vendosura në mënyrë të kundërligjshme si në Komunën e Shtërpçës.⁵² AIP ka përgatitur një plan inspektimi për vitin 2023.⁵³

Nga analiza e vendimeve të AIP-së të publikuara në faqen e saj, të cilat kryesisht ose vendosin gjobë ose urdhërojnë ndalim të përpunimit të të dhënave personale, shihet se rastet me të shpeshta të shkeljes së dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga ana e kontrolluesve kanë të bëjnë me:

- ***Përpunimin e të dhënave në kundërshtim me kërkesat ligjore (në kundërshtim me kriteret ligjore dhe parimet e përpunimit të të dhënave personale të parapara me ligj)***

Rastet më të shpeshta kur kontrolluesit përpunojnë të dhëna personale në kundërshtim me kërkesat ligjore të LMDHP janë rastet kur veprohet duke moszbatuar së paku njërin nga kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale, të paraparë në Nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të trajtuara në kapitullin “3.2.1.2 Kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale” të këtij raporti, apo edhe kur nuk respektohen parimet e përpunimit të të dhënave personale, të parapara në Nenin 4 të ligjit.

51 <https://betimiperdrejtesi.com/sogojeva-dermaku-me-2022-aip-gjeti-se-vetem-dy-komuna-i-kishin-vendosur-sipas-ligjit-kamerat-ne-sheshet-publike/>.

52 <https://zeri.info/aktuale/490795/aip-ja-konfiskon-kamerat-ilegale-ne-shterpce/>.

53 <https://aip.rks-gov.net/download/plani-i-inspektimit-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale/>.

- **Vëzhgimi me kamerë në kundërshtim ke kërkesat e parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Me rastin e përpunimit të të dhënave personale duke shfrytëzuar sistemin e vëzhgimit me kamerë, kontrolluesit janë të obliguar që të veprojnë sipas dispozitave përkatëse të LMDHP, duke zbatuar dispozitat e përgjithshme dhe ato të veçanta të sistemit të vëzhgimit me kamerë. Kontrolluesit këshillohen që para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë, krahas zbatimit të dispozitave ligjore, të kenë parasysh një “listë të kontrollit” me çështjet, si më poshtë:

- **Qëllimi** – A ekziston një qëllim i qartë për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë?
- **Ligjshmëria** – Cila është baza ligjore për përdorimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë?
- **Domosdoshmëria** – A mund të demonstrohet se vendosja e sistemit të vëzhgimit me kamerë është e nevojshme për të arritur qëllimin tuaj?
- **Proporcionaliteti** – Nëse sistemi i vëzhgimit me kamerë do të përdoret për qëllime të tjera përveç sigurisë, a jeni në gjendje të demonstroi dhe të arsyetoni se këto përdorime të tjera janë proporcionale?
- **Siguria** – Çfarë masash do të ndërmerren për të siguruar regjistrimet e sistemit të vëzhgimit me kamerë të jenë të siguruara dhe të sigurta nga ndërhyrjet e jashtme dhe nga mundësia e cenimit të privatësisë së subjekteve, si nga ana teknike ashtu edhe organizative?
- **Ruajtja** – Për sa kohë do t’i ruani regjistrimet, duke marrë parasysh që ato nuk duhet të mbahen për më shumë se një muaj, përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime?
- **Transparenca** – Si do t’i informoni njerëzit që po regjistroni imazhet e tyre dhe a do t’u jepni atyre informacione të tjera të kërkuara nga detyrimet e transparencës, qasjes sipas kërkesës në të dhënat e tyre personale?

Në shumë raste, AIP ka konstatuar se kontrolluesit nuk kanë vepruar në linjë me këto kërkesa.

- **Marketingu i drejtpërdrejtë**

Kontrolluesit përdorin të dhënat personale për qëllime të ofrimit të mallrave dhe shërbimeve tek subjektet e të dhënave personale përmes shërbimeve postare, thirrjeve telefonike, postës elektronike apo formave të tjera të komunikimit⁵⁴. Edhe tek marketingu i drejtpërdrejtë, kontrolluesi obligohet që të zbatoj së paku njërin nga kriteret ligjore të përpunimit të parapara në Nenin 5 të LMDHP, ku si kriter ligjor që më së shpeshti përdoret tek marketingu i drejtpërdrejtë është “pëlqimi” nga subjekti i të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, në proces të mbikëqyrjes së Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë vitit 2022 ka shqiptuar gjithsejtë tetë (8) gjoba⁵⁵ ndaj institucioneve të sektorit publik dhe privat, si në tabelën në vijim:

Institucioni	Gjoba	Shkelja ligjore
Administratës Tatimore të Kosovës	20.000 €	Përpunim i kundërligjshëm të të dhënave personale.
Komuna e Podujevës	20.000 €	Përpunim i kundërligjshëm të të dhënave personale.
Sigal Uniqa Group Austria	50.000 €	Shkelja e dispozitave për sigurinë e të dhënave personale, dhe shkelje e përgjithshme e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	30.000 €	Përpunim i kundërligjshëm i të dhënave personale.
B.B Prishtinë (person fizik, të dhëna të anonimizuar)	20.000 €	Përpunim i kundërligjshëm të të dhënave personale.

54 <https://aip.rks-gov.net/download/udhezues-per-perpunimin-e-te-dhenave-personale-per-qellim-te-marketingut-te-drejtperdrejte-2/?wpdmdl=2266&refresh=64c9fef145d7a1690959601>.

55 <https://aip.rks-gov.net/vendimet-nga-ankesat/vendimet-nga-ankesat-e-mbrojtjes-ne-te-dhena-personale/>.

"Bluechip International" L.L.C.	5.000 €	Përpunim i kundërligjshëm të të dhënave personale.
"Kayalar Telekom" Sh.P.K.	4.000 €	Përpunim i kundërligjshëm të të dhënave personale.

Tabela 2. Gjobat për Shkelje të të Dhënave Personal (Burimi: AIP).

Ndërsa, deri me 30 qershor 2023, në Agjencinë për Informim dhe Privatësi figuron një (1) gjobë e shqiptuar ndaj Partisë Social Demokratë të Kosovës⁵⁶ – gjobë në vlerë prej 20.000 € për shkak të përpunimit të kundërligjshëm të të dhënave personale.

3.5 Sfidat në Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Disa nga sfidat me të cilat në vazhdimësi është ballafaquar Agjencia për Informim dhe Privatësi për sa i përket fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, janë si vijon:

- Mungesa e kapaciteteve njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, e përcjellë me mungesa në pozita të rëndësishme brenda institucionit.

Ky fakt është evidentuar në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2022, por edhe në raportin vjetor të Punës të AIP për vitin 2022, si dhe në Planin e Performancës për vitin 2023⁵⁷. Këto sfida institucionale janë reflektim edhe i kapaciteteve të limituara buxhetore për të rekrutuar personel, për të trajnuar atë në linjë me zhvillimet në vendet e BE-së, edhe sa i përket qasjes po edhe mbrojtjes së të dhënave personale. Një numër i konsiderueshëm i pozitave profesionale të AIP të aprovuara me buxhet dhe sipas organogramit, mbeten të paplotësuara, gjë që sjellë pasoja në kualitetin dhe efikasitetin e AIP⁵⁸.

- Numri i kufizuar i të punësuarve në kuadër të Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave, me theks të veçantë mungesa e theksuar e Inspektorëve, të cilat kanë në mandat mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nevoja për ngritje të kapaciteteve në formë trajnimi të zyrtarëve të AIP është vazhdueshme, duke pasur parasysh kompleksitetin e fushës.

- Mungesa e kapaciteteve institucionale të kontrolluesve (të institucioneve publike dhe private), duke përfshirë mungesën e vetëdijes për të respektuar kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo përfshinë edhe moscaftimin e zyrtarëve për mbrojtje të të dhënave personale, mungesë e procedurave dhe politikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe nevojë për trajnime. Roli informues, trajnues dhe vetëdijesues i AIP është tejet i nevojshëm në këtë aspekt.

- Mungesa e udhëzuesve që derivojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nevoja për nxjerrjen e udhëzuesve të ndryshme nga ana e AIP, me qëllim të lehtësimit të zbatimit të ligjit nga ana e kontrolluesve është evidente. Nxjerrja e këtyre udhëzuesve praktikë me qëllim të zbatimit të ligjit në veçanti për sa i përket kapitujve të veçantë, do të ishte ndihmesë e madhe për kontrolluesit, të cilët zbatojnë dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në anën tjetër, sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen *subjektet e të dhënave personale* janë:

- Përpunimi i të dhënave në kundërshtim me kërkesat ligjore (në kundërshtim me kriteret ligjore dhe parimet e përpunimit të të dhënave personale të parapara me ligj);
- Vëzhgimi me kamerë në kundërshtim me kërkesat e parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; dhe
- Marketingu i drejtpërdrejtë.

56 <https://aip.rks-gov.net/vendimet-nga-ankesat/vendimet-nga-ankesat-e-mbrojtjes-ne-te-dhena-personale/>.

57 <https://aip.rks-gov.net/download/plani-i-performances-per-vitin-2023/?epdmdl=2686&refresh=64c9fb-63976ca1690958691>.

58 <https://aip.rks-gov.net/download/plani-i-performances-per-vitin-2023/?epdmdl=2686&refresh=64c9fb-63976ca1690958691>.

4. REZULTATE NGA DISKUTIMET REGJIONALE DHE ANKETIMI

4.1 Diskutimet Informuese Regjionale

Platforma CIVIKOS, në bashkëpunim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ka organizuar shtatë sesione informuese në të gjitha regjionet e Kosovës. Në këto sesione informuese regjionale të organizuara në Gjilan, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë, Prizren dhe Prishtinë, kryesisht kanë marrë pjesë përfaqësues të OJQ-ve, mediave dhe Këshillëve Lokale. Në shumicën e rasteve, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga institucionet komunale. Këto sesione janë organizuar në formë bashkëbisedimi me qëllim të promovimit të rolit të AIP-së dhe dy fushave të përgjegjësisë së AIP-së. Gjatë këtyre sesioneve janë parashtruar pyetje dhe janë dhënë përgjigje nga përfaqësuesit e AIP.

Në këto sesione informuese është bërë një prezantim i Agjencisë për Informim dhe Privatësi nga zyrtarë të saj, duke përfshirë mandatin dhe përgjegjësitë e saj ligjore. Është bërë një prezantim të përgjithshëm të kornizës ligjore që mbulon Qasjen në Dokumente Publike, duke përfshirë detyrimet e institucioneve dhe të drejtat e qytetarëve për të kërkuar qasje, si dhe rolit të AIP në mbikëqyrjen e ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Është prezantuar edhe korniza ligjore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke përfshirë legjislacionin e aplikueshëm, detyrimet e kontrolluesve të të dhënave dhe rolin e AIP si një institucion i pavarur në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. AIP dhe CIVIKOS kanë shfrytëzuar këto sesione për të shpërndarë materiale promovuese për qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat janë vlerësuar nga pjesëmarrësit.

Nga diskutimet gjatë këtyre sesioneve, vërehet se shumica e pjesëmarrësve nga OJQ-të kanë njohuri bazike rreth të drejtës për të kërkuar dokumente publike, dhe disi janë të informuar edhe me procedurat ligjore që lidhen me qasjen në dokumente publike. Ekziston një bindje e përgjithshme se qasja në dokumente publike ka shënuar progres përgjatë viteve të fundit. Megjithatë, evidentohen shumë raste kur institucionet publike refuzojnë qasjen, ofrojnë përgjigje të kufizuar ose heshtin. Përfaqësuesit e institucioneve në shumë raste kanë pranuar mungesën e kapaciteteve njerëzore për të ofruar qasje në kohë, veçanërisht në rastet e kërkesave për qasje në dokumente publike që kanë të bëjnë me procedura prokurimi. Në disa raste janë përmendur shembuj pozitivë, ku ndërhyrja e OJQ-ve ka bërë që institucionet publike të rrisin transparencën dhe të publikojnë dokumente që përndryshe do të duhej të ishin të publikuara në mënyrë proaktive. Në secilën nga këto sesione informuese, përfaqësuesit e AIP kanë ofruar informacione të qarta rreth cilat dokumente janë publike, cilat dokumente nuk bëhen publike, përfshirë ato që kanë të bëjnë me sekretin afarist, pronësinë intelektuale, dhe anonimizimin e të dhënave personale. Njëkohësisht, është diskutuar edhe për dokumentet e klasifikuara, nëse ato janë nënshtruar procedurës së klasifikimit.

Edhe pse AIP ka zhvilluar trajnime për zyrtarët për qasje në dokumente publike dhe institucionet publike, dhe ata kanë të drejtë të drejtohen tek AIP nëse nuk e kanë të qartë kërkesën për qasje, nga

diskutimet është vërejtur nevoja për promovim të mëtejshëm të qasjes në dokumente publike dhe për të rritur kapacitetet e institucioneve publike për të trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike në mënyrë të duhur. Rritja e transparencës së institucioneve publike, përmes publikimit proaktiv të dokumenteve, mbetet një sfidë.

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, edhe pse ka një rritje të vetëdijesimit nga OJQ-të dhe institucionet publike, gjendja mbetet shumë sfiduese në terren. Disa nga situatat më problematike të trajtuara përfshijnë rastet e kamerave të vendosura në kundërshtim me kërkesat ligjore, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave pa bazë ligjore, marketingun e drejtpërdrejtë nga ana e sektorit të biznesit, keqpërdorimin e të dhënave personale dhe vjedhjen e identitetit, publikimin e të dhënave personale pa autorizim, publikimin e të dhënave personale nga mediat, dhe situata të ngjashme. Nga diskutimet, është konkluduar se një numër i konsiderueshëm i OJQ-ve mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre, por nuk kanë ndonjë politikë të brendshme për të dhënat personale.

Nga diskutimet është konkluduar se Agjencia për Informim dhe Privatësi, edhe pse është funksionalizuar me mandatin aktual para dy vitesh, megjithatë, ka mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore për të kryer inspektime dhe për të trajtuar numrin e madh të rasteve të ndërlidhura me Mbrojtjen e të Dhënave Personale. AIP aktualisht funksionon me përafërsisht gjysmën e kapaciteteve të nevojshme për të përmbushur mandatin e saj në të dy fushat e kompetencave të saj. Përkundër kapaciteteve të kufizuara, AIP ka arritur që gjatë dy viteve të fundit të trajtoj një numër të madh të rasteve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale pa bazë ligjore, në veçanti përmes vendosjes së kamerave në hapësira publike, si dhe raste tjera të shkeljes të të dhënave personale, qoftë sipas ankesës apo në mënyrë ex officio.

4.2 Anketimi

Krahas sesioneve informuese, është përgatitur një pyetësor që ka mbuluar pjesën e qasjes në dokumente publike dhe pjesën e mbrojtjes së të dhënave personale. Pyetësori, kishte për qëllim të analizojë se sa janë të informuara OJQ-të dhe bizneset me këto dy fusha që mbulon AIP, sa janë këto subjekte në pajtueshmëri me kërkesat ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, dhe në të njëjtën kohë të ndihmojë AIP-së në zhvillimin e programeve të ndërhyrjes në këto fusha për të përmbushur mandatin e saj. Prandaj, anketa është menduar si një mjet për të kuptuar gjendjen aktuale sa i përket nevojave dhe zbatimit të ligjit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Si pjesë e anketës janë pranuar gjithsej 124 pyetësor të plotësuar nga OJQ-të dhe bizneset. Ndonëse numri i pyetësorëve të plotësuar nuk është i madh, marrë parasysh numrin e OJQ-ve dhe bizneseve të regjistruara, numri i kufizuar i përgjigjeve tregon për mungesë të informimit dhe vetëdijes së OJQ-ve dhe sektorit të biznesit për rëndësinë e qasjes në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, por edhe obligimeve që kanë në veçanti në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.



Anketa është plotësuar në mënyrë anonime dhe në vijim është përfshirë një analizë e disa prej pyetjeve kryesore që ndërlidhen me fushëveprimin e këtij raporti, duke përfshirë edhe një interpretim të tyre.

4.2.1 Qasja në Dokumente Publike



Informimi lidhur me Rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Në pyetjen se “A keni dëgjuar më parë për Agjencinë për Informim dhe Privatësi?”, rreth 79.2% e të anketuarve që janë përgjigjur e që përfaqësojnë OJQ-të janë përgjigjur se kanë dëgjuar më parë për AIP, ndërsa 20.8% e tyre janë përgjigjur negativisht. Tek të anketuarit që përfaqësojnë sektorin e biznesit vetëm 52.6% e tyre janë përgjigjur se kanë dëgjuar më herët për AIP, kundrejt 47.4% që nuk kanë dëgjuar më herët për AIP. Ndërsa, sa i përket transparencës së institucioneve publike, vetëm 12% e të anketuarve mendojnë se institucionet publike janë transparente dhe lehtë të qasshme, 58% pajtohen



pjesërisht me konstatimin se institucionet publike janë transparente dhe lehtë të qasshme, ndërsa 30% nuk pajtohen.



Në pyetjen “A keni njohuri për kërkesat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike”, 64.3% e OJQ-ve janë përgjigjur se kanë njohuri me kërkesat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ndërsa 35.7% e tyre deklarojnë se nuk kanë njohuri me këto kërkesa. Në të njëjtën pyetje, rreth 52.6% e bizneseve janë përgjigjur se kanë njohuri për kërkesat ligjore, kurse rreth 47.4% se nuk kanë njohuri përkitazi me këto kërkesa. Ndërsa në pyetjen “A keni bërë ndonjë kërkesë për qasje në dokumente publike?”, 38.8% e OJQ-ve kanë pohuar se kanë bërë kërkesë për qasje në dokumente publike, kundrejt 61.2% e tyre që nuk e kanë bërë asnjëherë kërkesë të tillë. Vetëm rreth 21% e bizneseve që i janë përgjigjur pyetësorit kanë pohuar se kanë parashtruar ndonjëherë kërkesë për qasje në dokumente publike, ndërsa 79% e tyre nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë të tillë.





Në Pyetjen se “A u është dhënë qasja në dokumentet e kërkuara?”, rreth 47% e respondentëve janë përgjigjur se u është dhënë qasje në dokumentin e kërkuar, 20% u është dhënë qasje e kufizuar, dhe 33% se nuk u është dhënë qasje. Vetëm 23% e atyre që nuk është dhënë qasja janë përgjigjur se janë ankuar ndaj vendimit për mos dhënie të qasjes apo qasjes së kufizuar. Në 39% të rasteve ankesa ka qenë e suksesshme dhe është ofruar qasja, ndërsa, në 61% të rasteve ankesa ka qenë e pasuksesshme.



4.2.2 Mbrojtja e të Dhënave Personale

Informimi për kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në pyetjen “A keni njohuri për kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, 59% e OJQ-ve janë përgjigjur se kanë njohuri me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërsa 41% e tyre deklarojnë se nuk kanë njohuri me këto kërkesa. Në të njëjtën pyetje, rreth 63% e bizneseve janë përgjigjur se kanë njohuri për kërkesat ligjore kurse rreth 37% se nuk kanë njohuri përkitazi me këto kërkesa. Ndërsa në pyetjen “A e dini se ku mund të ankohet individi nëse i shkelen të dhënat personale?”, 50.5% e OJQ-ve kanë këtë informacion, kundrejt 49.5% e tyre që nuk e kanë këtë informacion. Vetëm 32% e bizneseve që i janë përgjigjur pyetësorit e kanë të qartë ku mund të ankohet individi në rast të shkeljes të të dhënave personale, ndërsa 68% e atyre që janë përgjigjur nuk e kanë këtë informacion.



Në pyetjen se “Cili institucion mendoni që më së shpeshti bën shkelje të të dhënave personale?” ekziston perceptimi se institucionet publike më së shpeshti bëjnë shkelje të të dhënave personale, pasuar nga ndërmarrjet publike, spitalet, bankat komerciale, supermarketet, çerdhet e kështu më radhë. Në këtë pyetje respondentët kishin mundësinë të zgjidhnin më shumë se një opion.



Politikat dhe procedurat e brendshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në pyetjen se *“A ka organizata/biznesi juaj një politikë të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale?”*, rreth 51% e OJQ-ve janë përgjigjur se OJQ ka një politikë të brendshme të të dhënave personale, kundrejt 49% që janë përgjigjur se OJQ nuk ka një politikë të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale. Në të njëjtën pyetje, rreth 26.3% e bizneseve janë përgjigjur se ka një politikë të brendshme të mbrojtjes të të dhënave personale, kundrejt 73.7% që janë përgjigjur se biznesi nuk ka një politikë të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga subjektet që janë përgjigjur se nuk kanë politika të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër shkaqet kryesore për mungesën e një politike të tillë është: mungesa e kapaciteteve për përgatitjen e një politike të tillë në 39% të rasteve tek OJQ-të dhe në 33% të rasteve të bizneset; mungesa e njohurive për kërkesat ligjore për një politikë të tillë në 26.8% te OJQ dhe 40% te bizneset; dhe pasiguria nëse kërkesat e ligjit janë të aplikueshme për këto subjekte me 25% te OJQ-të dhe rreth 40% te bizneset. Vetëm 25% e OJQ-ve dhe 40% e bizneseve që janë përgjigjur se nuk kanë politikë të brendshme të të dhënave personale janë përgjigjur se mungesa e një politike të tillë paraqitet për shkak se ata nuk mbledhim dhe përpunojnë të dhëna personale. Rreth 23.5% e bizneseve dhe rreth 21.3% e OJQ-ve që nuk kanë politika të brendshme nuk planifikojnë të krijojnë politikë të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale për shkak se nuk kanë kapacitete. Nëse u ofrohet mbështetje profesionale për hartimin e një politike të brendshme këtë do ta bënin 52.9% e bizneseve dhe 54.7% e OJQ-ve që nuk kanë politika të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa 29% nga bizneset dhe 13% nga OJQ-të do e përgatisin me kapacitetet e tyre. *Sa i përket pyetjes “A keni ndonjë procedurë të brendshme për trajtimin e shkeljeve të të dhënave personale?”*, 63.3% e OJQ-ve kanë theksuar se kanë një procedurë të tillë, ndërsa 36.7% nuk kanë procedurë të tillë të brendshme. Tek bizneset që janë përgjigjur, 68.4% kanë një procedurë të brendshme të trajtimit të shkeljes të të dhënave personale, kundrejt 31.6% të cilët janë përgjigjur se nuk kanë një procedurë të brendshme.



Në pyetjen se *“A bënë organizata juaj vlerësim të brendshëm të rreziqeve sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale”*, 41.4% e OJQ-ve që janë përgjigjur kanë theksuar se OJQ bënë një vlerësim të tillë, kundrejt 58.6% që janë përgjigjur se nuk bëhet ndonjë vlerësim i tillë. Tek bizneset vetëm 15.8% janë përgjigjur pozitivisht, kundrejt 84.2% e tyre që kanë theksuar se nuk bëhet një vlerësim i brendshëm i rreziqeve sa i përket mbrojtjes të të dhënave personale.

Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale dhe trajnimi i personelit sa i përket mbrojtjes të të dhënave personale


Në pyetjen se *“A është ndonjëri nga stafi juaj i/e trajnuar për mbrojtjen e të dhënave personale?”*, vetëm 25.8% e OJQ-ve theksojnë se ndonjëri nga personeli i tyre është i trajnuar sa i përket mbrojtjes të të dhënave personale. Përqindja e bizneseve që janë përgjigjur se kanë staf të trajnuar për mbrojtjen e të dhënave personale është vetëm 10.5%. Ndërsa vetëm 26% e OJQ-ve dhe 31.6% e bizneseve kanë raportuar se kanë një zyrtar të brendshëm përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale

Në pyetjen *“A mbledhin dhe procesojnë të dhëna personale?”*, 73% e OJQ-ve dhe 63% e bizneseve janë përgjigjur se mbledhin dhe procesojnë të dhëna personale. Kurse 27% e OJQ-ve dhe 37% e bizneseve se ato nuk mbledhin dhe nuk procesojnë të dhëna personale. 88.7% e OJQ-ve dhe 68.4% e bizneseve deklarojnë se marrin paraprakisht pëlqimin e subjekteve të të dhënave para se të mbledhin dhe përpunojnë të dhënat personale. Po ashtu, nga përgjigjet e pranuar, del se 41% e OJQ-ve dhe 79% e bizneseve kanë të instaluar kamera sigurie jashtë objekteve të tyre. 46% e OJQ-ve dhe 65% e bizneseve kanë deklaruar se kanë të vendosura shenjat dhe vendimin që njoftojnë personat e tjerë për ato kamera.



Nga përgjigjet e pranuar shihet se OJQ-të dhe bizneset mbledhin dhe përpunojnë të dhëna të ndryshme personale, mbi baza të ndryshme ligjore, duke përfshirë kontratën dhe pëlqimin. Të dhënat e klientëve (e-mail, numër telefoni, etj.) mblidhen nga rreth 78.5% e OJQ-ve dhe 75% e bizneseve. Të dhënat shëndetësore janë raportuar se mblidhen nga 22.8% e OJQ-ve dhe 17% e bizneseve; Lista të pjesëmarrësve në aktivitete është raportuar nga 65% e OJQ-ve dhe 25% e bizneseve; Fotografi të të pranishmëve 67% e OJQ-ve dhe 33% e bizneseve, të dhënat nga lista e pagave, kontratat dhe anketat po ashtu janë raportuar si mënyrë e mbledhjes së të dhënave personale.



5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

5.1 Qasja në Dokumente Publike në Republikën e Kosovës

- Kosova ka një kornizë ligjore për qasje në dokumente publike që është në linjë me standardet ndërkombëtare të kësaj fushe. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron garanci për qasje në dokumente publike, ndërsa Ligji për Qasje në Dokumente Publike i vitit 2019 rregullon në mënyrë të detajuar procesin e qasjes në dokumente publike, dhe përcakton mekanizmat institucional për adresimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe adresimin e ankesave për refuzim apo kufizim të qasjes.
- Organizatat e shoqërisë civile dhe mediat në vazhdimësi kanë luajtur rol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në Republikën e Kosovës. AIP është duke bashkëpunuar ngushtë me organizatat e shoqërisë civile për të implementuar projekte drejt këtij qëlimi.
- Ligji aktual ka dispozita janë kundërthënëse, që krijojnë paqartësi se cilat akte nënligjore i nxjerrë AIP dhe cilat i nxjerrë Qeveria me propozim të AIP-së. Kjo çështje do duhej qartësuar në të ardhmen.
- AIP është kompetente vetëm të siguroj se institucionet i publikojnë dokumentet që kërkohen me ligj, por jo të ndërhyj në kompetencat qeveritare për menaxhimin e uebfaqeve dhe të diktoj përmbajtjen e tyre. Rrjedhimisht, nuk është kompetente as të nxjerrë akte nënligjore të kësaj fushe, por të bashkëpunoj në këtë proces për të reflektuar kërkesat e ligjit. Ndaj, Udhëzuesi për përmbajtjen e faqeve të internetit të institucioneve publike (2022) ka disa paqartësi në karakterin e tij juridik, pasi i njëjti nuk mund të jetë akt nënligjor detyrues. Ky udhëzues mund vetëm të udhëzoj institucionet për sa u përket kërkesave minimale për të publikuar dokumentet e kërkuara me Ligjin. Prandaj, AIP do të mund të ofronte me shumë sqarime për institucionet publike nga perspektiva e kërkesave të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, pasi vetëm sa i përket këtij aspekti AIP është kompetente.
- Agjencia për Informim dhe Privatësi gjatë dy viteve të fundit është funksionalizuar në kuptimin institucional dhe ka nxjerr shumicën e akteve nënligjore dhe udhëzues informimi, të cilat ofrojnë sqarime më të detajuara dhe më specifike lidhur me të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, si dhe opsionet që duhet të ndiqen, me qëllim të realizimit të kësaj të drejte. Megjithatë, mbetet shumë për tu bërë në shtimin e kapaciteteve të vetë AIP si institucion mbikëqyrës dhe të institucioneve publike të cilat janë përgjegjëse për ofrimin e qasjes në dokumente publike. Nga analiza e statistikave të ankesave, vërehet që roli i AIP në rritjen e transparencës së institucioneve publike është esencial, dhe se institucionet publike në shumicën e rasteve kanë kufizuar ose refuzuar qasjen në dokumente publike pa bazë.
- Nga të dhënat statistikore të publikuara nga AIP për periudhën 2021-2023, vërehet një rënie e raportimit të statistikave për qasje në dokumente publike nga institucionet publike në AIP për vitin 2022. Në të njëjtën kohë është raportuar zvogëlim i numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 dhe rritje e numrit të rasteve në të cilat është kufizuar dhe refuzuar qasja në dokumente publike. Vërehet edhe rritje e numrit të ankesave të dorëzuara në AIP duke krahasuar periudhën korrik 2021- qershor 2023. Gjithashtu, statistikat tregojnë se shumica e rasteve të kufizimit ose refuzimit të qasjes nga ana e institucioneve publike,

kanë qenë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Anketat me OJQ dhe biznese, por edhe numri i madh i ankesave të dorëzuara në AIP, janë tregues se institucionet publike ende nuk janë plotësisht transparente, rrjedhimisht nuk publikojnë në mënyrë proaktive dokumentet dhe në shumë raste kufizojnë ose refuzojnë qasjen në dokumente publike. Duhet të inkurajohet dhe promovohet një kulturë e komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët në lidhje me qasjen në dokumentet publike.

- Anketa me Organizata Joqeveritare dhe biznese, është tregues se një numër i konsiderueshëm i tyre nuk janë të informuar për rolin dhe mandatin e AIP-së. Rrjedhimisht, ofrimi i informimit shtesë nga AIP është i domosdoshëm.
- Institucionet publike duhet të zbatojnë me kujdes dhe pa pengesa Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Kjo përfshin zbatimin e kërkesave të ligjit për publikimin proaktiv të dokumenteve publike dhe ofrimin e qasjes së plotë në dokumente publike. Bashkëpunimi me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, duke përfshirë zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve të saj, përbënë detyrim ligjor dhe do të ndihmojë në forcimin e transparencës së gjithë institucioneve publike. Kjo përfshinë edhe obligimin për pagesën e gjobave të shqiptuara nga AIP.
- AIP ka disa vështirësi për sa i përket përmbartimit të gjobave nga ana e disa institucioneve publike. Ka mundësi ligjore të bëjë ekzekutimin përmes përmbartimit privat, megjithatë, kjo ka një kosto financiare për buxhetin e AIP, që nuk e ka të pëfshirë deri më tani këtë qëllim. Ekzekutimi përmes ATK-së nuk është praktikuar asnjëherë deri më tani, dhe në vetvete do të ishte problematik për ATK-në, duke pasur parasysh kapacitetet njerëzore. Përmbartimi nuk është i mundshëm as përmes Thesarit, për shkak të kufizimeve aktuale ligjore. Çështja e përmbartimit të gjobave të shqiptuara për institucionet publike duhet trajtuar në një kontekst më të gjerë ligjor në kuadër të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe jo vetëm për ato të shqiptuara nga AIP.
- AIP duhet të investojë në rritjen e kapaciteteve njerëzore brenda institucionit. Kjo përfshin rekrutimin dhe trajnimin e personelit për të trajtuar çështjet e qasjes në dokumente publike në përputhje me kërkesat ligjore.
- Është e rëndësishme që institucionet publike të ofrojnë trajnim dhe ndërgjegjësim të zyrtarëve të tyre për të ofruar qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesat e ligjit për qasje në dokumente publike. AIP mund të luajë një rol kyç në këtë proces duke ofruar udhëzime dhe trajnime për zyrtarët publikë.
- Është e nevojshme që institucionet publike të harmonizojnë aktet e tyre të brendshme me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike për të siguruar konsistencë dhe zbatim të drejtë të legjislacionit në fushën e qasjes në dokumente publike.
- Rekomandohet që çdo akt nënligjor i nxjerrë nga AIP të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Përveç aspektit formal juridik, publikimi në Gazetën Zyrtare do të kishte efekte më të mira edhe të informimit për kornizën ligjore në fuqi.

5.2 Mbrojtja e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës

- Kosova ka një ligj për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili tani për tani është në linjë me kërkesat e BE-së në këtë fushë. Mirëpo, nevojiten edhe mekanizmat zbatuese dhe zbatimi në praktikë të jenë në linjë me kërkesat e Acquis të BE-së. Nëse analizohet në tërësi, sistemi i mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë ballafaqohet me sfida të konsiderueshme në zbatim të drejtë të kësaj baze ligjore në praktikë.
- Gjatë dy viteve të fundit, AIP ka ndërmarrë veprime në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, në veçanti duke parandaluar mbledhjen dhe përpunimin e paautorizuar dhe pa pazë ligjore të të dhënave. Janë shqiptuar një numër i konsiderueshëm gjobash, të cilat besohet se do të kenë efekt pozitiv në vetëdijesimin e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave personale.

Numri i rasteve të shkeljeve është tregues edhe i sfidave me të cilat ballafaqohet Kosova në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale.

- Duke pas parasysh fushëveprimin e gjerë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, që mbulon edhe sektorin privat, shtimi i kapaciteteve njerëzore të AIP është thelbësor për zbatim të duhur të kërkesave ligjore.
- Sektori privat dhe ai publik ende nuk kanë arritur të vetëdijesohen në masë të duhur dhe të krijojnë kapacitete sa i përket kërkesave ligjore që ndërlidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Prandaj, roli i AIP në promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale, por edhe në ofrimin e përkrahjes për kontrolluesit dhe përpunuesit për të qenë në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbetet esencial.
- AIP ende nuk ka kompletuar të gjithë kornizën e legjislacionit sekondar të paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mirëpo parashihet të bëhet në Planin Legjislativ të Akteve Nënligjore për Vitin 2023. Këto akte nënligjore janë komplekse dhe ende nuk janë rregulluar në mënyrë të detajuar as në vendet e rajonit.
- Nga anketa është vërejtur se shumica e OJQ-ve dhe bizneseve janë kontrollues dhe përpunues të të dhënave personale. Megjithatë, një përqindje e lartë e tyre nuk janë të vetëdijshëm për kërkesat ligjore dhe obligimet që parasheh Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kundrejt tyre me rastin e përpunimit të të dhënave personale. Shumë nga të anketuarit të përfaqësojnë këtë sektor nuk janë të vetëdijshëm se ku duhet dorëzuar ankesa në rast të shkeljes të të dhënave personale. Vërehet mungesë e madhe e politikave të brendshme të privatësisë, mungesë e kapaciteteve njerëzore të trajnuara sipas kërkesave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke përfshirë edhe zyrtar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Promovimi i mëtejshëm i rëndësisë së privatësisë dhe mbrojtjes të të dhënave personale mbetet domosdoshmëri. Në të njëjtën kohë, edhe promovimi i rolit dhe mandatit të AIP si një institucion mbikëqyrës për fushën e mbrojtjes të të dhënave personale është me rëndësi për të rritur pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Rekomandohet që Agjencia për Informim dhe Privatësi të kujdeset për rritjen e kapaciteteve njerëzore brenda institucionit. Kjo përfshin rekrutimin dhe trajnimin e personelit në përputhje me zhvillimet në vendet e Bashkimit Evropian në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Rekrutimi i pozitave të lira profesionale në AIP, të cilat veçse janë të aprovuara me buxhet, duhet të jetë një prioritet dhe do të ndikojë në rritjen e cilësisë së punës dhe efikasitetin e punës së AIP. Në veçanti është e rëndësishme të rritet numri i të punësuarve në Departamentin për Mbrojtjen e të Dhënave, duke përfshirë më shumë inspektorë të specializuar. Nevoja për trajnim të vazhdueshëm të zyrtarëve të AIP është thelbësore për t'u siguruar që ata të jenë në dijeni të ndryshimeve të përditësuara të legjislacionit dhe kompleksitetit të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale.
- AIP duhet të luajë një rol aktiv në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve publike dhe private për të respektuar kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo përfshin ndihmën në ndërgjegjësimin e tyre, zhvillimin e procedurave dhe politikave për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ofrimin e trajnimeve të nevojshme. AIP mund të luajë një rol kyç informues dhe trajnues në këtë proces.
- Ofrimi i manualëve shtesë dhe këshillave për të nevojshme për sektorin privat, është shumë i kufizuar me numrin e kufizuar të kapaciteteve njerëzore aktuale të AIP-së. Prandaj, përmirësimi i kapaciteteve të AIP-së në dhënien e këshillave për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për sektorin privat duhet të jetë ndër prioritetet kryesore. Rekomandohet që AIP të nxjerrë udhëzues praktikë që ndihmojnë kontrolluesit në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto udhëzues do të ndihmojnë në lehtësimin e kuptimit dhe zbatimin e ligjit nga ana e tyre.
- Aktet nënligjore të nxjerra nga AIP mbi këtë fushë nuk janë publikuar në Gazetën Zyrtare të

Republikës së Kosovës. Përveç aspektit formal juridik, publikimi në gazetën zyrtare do të kishte efekte më të mira edhe të informimit për kornizën ligjore në fuqi. Rekomandohet që çdo akt nënligjor i nxjerrë nga AIP të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Përveç aspektit formal juridik, publikimi në Gazetën Zyrtare do të kishte efekte më të mira edhe të informimit për kornizën ligjore në fuqi.

